



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR LËNDOR PËR GJUHËN E HUAJ

Material ndihmës për mësuesit e gjuhës së huaj në arsimin e mesëm të ulët



KLASAT 6-9

TIRANË, 2018

Përgatitën udhëzuesin:

Ludmilla Stefani, IZHA

Viola Karapici, IZHA

Kontribuan:

Olta Mema, shkolla “Kongresi i Lushnjës”, Tiranë

Elida Reçi, shkolla “Sami Frashëri”, Tiranë

Rolanda Thimo, liceu artistik “Jordan Misja”, Tiranë

Shpresa Keço, shkolla “Hasan Prishtina”, Tiranë

Udhëzuesi për zhvillimin e lëndëve “Gjuhët e huaja” në arsimin e mesëm të ulët është produkt i konsultimeve dhe i diskutimeve me mësues dhe me specialistë të këtyre lëndëve në këtë cikël shkollimi.

Prodhim i IZHA-s, 2018

www.izha.edu.al

[Copy right © IZHA](#)

TABELA E PËRMBAJTJES

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”	3
1.1 Qëllimi i udhëzuesit	3
1.2 Struktura e udhëzuesit	3
II. RËNDËSIA E LËNDËS “GJUHË E HUAJ”	4
2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën “Gjuhë e huaj”	4
2.2 Shtrirja e lëndës “Gjuhë e huaj”	6
III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËR MJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”	8
IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR	11
V. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIE – NXËNIES NË GJUHË TË HUAJ	15
VI. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR	33
6.1 Llojet e planifikimeve	34
6.2 Planifikimi vjetor i lëndës	34
6.3 Planifikimi sipas periudhave	37
6.4 Planifikimi ditor	41
VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ	48
VIII. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRAT E NDRYSHME NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ	58
8.1 Kriteret për kryerjen e detyrave	58
8.2 Reflektimi ose komentit i mësuesit (Giving feedback).....	59
IX. TESTET E ARRITJEVE	60
9.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi	60
9.2 Hartimi i testit	61
9.3 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste.....	62
9.4 Modele testesh	66

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi kurrikular për lëndën “Gjuhë e huaj” synon të ndihmojë mësuesit e gjuhës së huaj në Arsimin e Mesëm të Ulët (AMU) në punën e tyre të përditshme për zbatimin e programeve mësimore të bazuar në kurrikulën me kompetenca, si edhe drejtuesit dhe specialistët e arsimit për monitorimin e kësaj kurikule.

Udhëzuesi është hartuar për të mbështetur këta mësues të planifikojnë mësimet krijuese, kuptimplote dhe argëtuese për nxënësit duke përzgjedhur veprimtari dhe strategji të përshtatshme, të cilat do të ndihmojnë nxënësin në procesin e marrjes së njohurive. Fokusi i është dhënë mësimdhënies dhe veprimtarive me në qendër nxënësin, pasi nxënësit mësojnë më mirë kur janë pjesë e këtij procesi. Ata mësojnë nëpërmjet situatave të të nxënit, teksteve të leximit, që trajtojnë tema të interesit të tyre dhe qepërshtaten me zhvillimin moshor dhe nivelin gjuhësor. Nxënësit gjithashtu realizojnë detyra dhe projekte që shkojnë përtej klasës dhe shkollës duke zbuluar në këtë mënyrë se si funksionojnë gjërat në shoqëri dhe në komunitet, pjesë e të cilit janë edhe ata.

1.2 Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi mundohet të japë përgjigje për një sërë pyetjesh dhe çështjesh të ngritura nga drejtuesit e shkollës, mësuesit, nxënësit, prindërit, të cilët herë pas here kanë dilemat e tyre në lidhje me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në lëndën e gjuhës së huaj.

Udhëzuesi përfshin:

1. Modele të zhvillimit të kompetencave kyçe nëpërmjet lëndës së gjuhës së huaj.
2. Modele të integritit ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënit
3. Metodologji për zhvillimin e lëndës së gjuhës së huaj
4. Modele të planifikimit kurrikular të lëndës gjuhë e huaj
 - a. Modele të planifikimit vjetor
 - b. Modele të planifikimit të periudhës
 - c. Modele të planifikimit ditor
 - d. Model planifikimi të projektit në lëndën “Gjuhë e huaj”
 - e. Modele të punës me PEGJ (Portofoli European i Gjuhëve)
5. Vlerësimi i nxënësve
 - a. Modele të vlerësimit të vazhduar.

- b. Modele të vlerësimit të portofolit.
6. Teste të arritjes:
 - a. Parimet e hartimit të testeve.
 - b. Llojet e pyetjeve që hartohen në teste.
 - c. Model testi për një periudhë.

Për trajtimin e këtyre çështjeve në këtë udhëzues operohet në dy drejtime:

Së pari, duke dhënë shembuj konkretë dhe modele për çështje të tilla si; planifikimi i mësimdhënies, vlerësimit, punës me portofol apo forma dhe metoda pune për realizimin me sukses të orës mësimore.

Së dyti duke dhënë sugjerime për një mësimdhënie më cilësore, duke pasur si kriter zbatimin e programit mësimor të lëndës ‘Gjuhë e huaj’.

II. RËNDËSIA E LËNDËS “GJUHË E HUAJ”

Lënda “Gjuhë e huaj” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht etj) ndihmon nxënësin të zhvillojë kompetencën kyçe të të shprehurit dhe komunikimit duke synuar zhvillimin gjuhësor dhe letrar, i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale, kulturore dhe emocionale të nxënësit duke patur për mission aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikiminë gjuhë të huaj. Lënda “Gjuhë e huaj” edukon nxënësin me të kuptuarin, pranimin, vlerësimin dhe respektimin e kulturave dhe mënyrave të jetesës së popujve të tjerë duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, kupton dhe ndërgjegjësohet se gjuha e huaj, si një subjekt njohurish, aftësish, kulturash dhe vlerash kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t’u përvetësuar.

Për më tepër në kontekstin e sotëm social dhe politik, ku lidhjet globale janë gjithnjë e më të qendrueshme, si dhe ku Shqipëria aspiron të integrohet në Bashkimin Europian, prirja kryesore është krijimi i një mjedisi shumëgjuhësor e shumëkulturor, në të cilin mësimi i gjuhës së huaj kontribuon si në shkëmbimet kulturore midis vendit tonë e vendeve të ndryshme, ashtu edhe për të udhëtuar botën, qoftë për shkollim apo për kënaqësi.

2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën “Gjuhë e huaj”

Qëllimet e lëndës së gjuhës së huaj në arsimin bazë janë;

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të thjeshta të llojeve të ndryshme, si dhe i të menduarit kritik e krijues;

- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë nxënësit;
- gjetja e informacionit dhe të kuptuarit e tij.

Me kurrikulën e re, gjuha e huaj është strukturuar me tri kompetenca, të cilat shpjegohen në tabelën e mëposhtme:

KOMPETENCAT E LËNDËS		REZULTATET (NIVELI A2)
1. GJUHËSORE <i>nënkupton përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.</i>	a. Fjalori	Zotëron dhe kontrollon fjalor të mjaftueshëm për të shprehur nevojat bazë të komunikimit dhe për të përballuar nevojat e thjeshta të mbijetesës.
	b. Saktësia gramatikore	Përdor struktura të thjeshta në mënyrë korrekte, por në mënyrë sistematike bën gabime bazë, si p.sh., ka tendecë të ngatërrojë kohët e foljeve dhe harron të bëjë përshtatjet, ndonëse zakonisht është e qartë se çfarë ai/ajo po përpiqet të thotë.
	c. Fonetika	Shqipton në përgjithësi qartë dhe kuptohet, me përjashtim të një aksenti të huaj, por ka nevojë për përsëritje të njohurive.
	d. Ortografia	Kopjon fjali rreth temave të përditshme, p.sh shpjegime si të shkojë diku. Shkruan me saktësi fonetike fjalë të shkurtra, që janë pjesë të fjalorit të tij.
2. SOCIO-GJUHËSORE <i>ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjëritit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore të cilat kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit, si dhe me faktorë të tjerë që</i>	a. Aktet e ligjëritit dhe komunikimit	Manaxhon shkëmbime shumë të shkurtra informacioni shoqëror duke përdorur përshendetje dhe shprehje të përditshme të mirësjelljes. Mund të bëjë dhe t'ju përgjigjet ftesave, sugjerimeve etj.

<i>influencojnë në stilin dhe rregjistrat e gjuhës.</i>		
3. PRAGMATIKE <i>ka të bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakort, përshendetjet etj).</i>	a. Fleksibiliteti	Zgjeron shprehjet e mësuara nëpërmjet një kombinimi të thjeshtë të elementeve të tyre.
	b. Pjesëmarrja në bashkëbisedim	Kërkon vemendje në një bashkëbisedim të thjeshtë. Përdor teknika shumë të thjeshta për të filluar, vazhduar dhe mbyllur një bashkëbisedim.
	c. Zhvillimi i temës	Tregon një histori ose përshkruan diçka duke u bazuar në një listë të thjeshtë çështjesh.
	d. Koherenca	Bashkon grupe fjalësh me lidhësa të thjeshta si “dhe”, “por” dhe “sepse”

Dy faktorë cilësorë të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:

- a. Rrjedhshmëria b. Saktësia e të shprehurit

Duke u bazuar tek kompetencat kyçe dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përmbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit,të dëgjuarit), **ndërveprimi**(të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit,produkti i të shkruarit) dhe **ndërhyrja** (përmbledhja, interpretimi, perifraximi,përkthimi etj). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë e **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.**

2.2 Shtrirja e lëndës “Gjuhë e huaj”

Lënda “Gjuhë e huaj” është planifikuar në kurrikulën bërthamë si një lëndë me rëndësi për formimin e nxënësit duke filluar që nga arsimi bazë dhe përbëhet nga gjuha e huaj e parë dhe gjuha e huaj e dytë.

Gjuha e huaj e pare fillon në shkallën e dytë (klasaIII) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasaXII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasaVI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasaXII).

Klasa	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	Niveli i synuar
Gjuha e huaj e parë	3	3	3	3	3	3	3	A2+
Gjuha e huaj e dytë	0	0	0	2	2	2	2	A1

Duke iu referuar *Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët* dhe programeve të lëndës “Gjuhë e huaj” në AMU, nxënësi synon të arrijë deri në fund të klasës së 9-të nivelin A2+.

Me poshtë jepet përshkrimi i nivelit A1 dhe A2 sipas shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët.

Shkalla Globale A 1	Nxënësi: Mund të kuptojë dhe të përdorë shprehje të përditshme dhe shprehje bazë që synojnë plotësimin e nevojave konkrete. Mund të prezantojë veten dhe të tjerët, të pyesë e të përgjigjet për detaje vetjake si; ku jeton, banon, njerëzit që njeh, sendet që ka etj. Mund të komunikojë në një mënyrë të thjeshtë nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë, qartë dhe është i gatshëm të ndihmojë.
---------------------	---

Shkalla Globale A 2	Nxënësi: Mund të kuptojë fjali dhe shprehje të përditshme që lidhen me fusha të nevojës më të domosdoshme si psh; informacion bazë rreth tij dhe familjes, në dyqan, gjeografia e vendit, puna/ët që bën etj. Mund të komunikojë për detyra të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë për çështje të njohura dhe të përditshme. Mund të përshkruajë me terma të thjeshta aspekte të formimit të tij/saj, mjedisit rrethues dhe çështje të fushave me interes/nevojë të drejtpërdrejtë.
---------------------	--

**shënim: Niveli A2+ është më i lartë se A2, gjithsesi ato kanë të njëjtat tipare kryesore, duke shtuar përshkrues të cilët fokusohen në sasinë e shkëmbimit të informacionit, duke përcaktuar si karakteristike të këtij niveli pjesëmarrjen më aktive të nxënësit në diskutime dhe bashkëbisedime duke u ndihmuar nga bashkëfolësi ose mësuesi.*

Këto përshkrime detajohen më tej në Portofolin European të Gjuhëve (PEGJ) dhe përdoren nga mësuesi si bazë për të përcaktuar nivelin e arritjeve të nxënësit për çdo klasë.

III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”

Lënda “Gjuhë e huaj” krijon hapësirë për nxënësin të zhvillojë jo vetëm kompetencat gjuhësore por edhe ato kyçe për dy arsye kryesore:

- a. Të nxënit është i orientuar drejt përdorimit të gjuhës në jetën e përditshme.

Përqasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) në të mësuarin e gjuhëve të huaja, është e orientuar drejt të vepruarit ku nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th., pjesëtar i shoqërisë, që ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi.

Komunikimi realizohet nëpërmjet veprimtarive gjuhësore, të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që ju jep atyre kuptim të plotë. Përqasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive, që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përqasjeje çdo formë përdorimi dhe nxënieje e një gjuhe, mund të përkufizohet si më poshtë:

“Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga nxënësi, i cili si individ dhe si aktor shoqëror zhvillon një numër kompetencash kyçe dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme (situatat e të nxënit) dhe kalon vështirësitë për t’u përfshirë në veprimtari gjuhësore. Këto veprimtari përfshijnë proceset gjuhësore, të cilat mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi, çon në përforcimin ose përmirësimin e kompetencave kyçe.”

Kjo përqasje ilustron në figurën e mëposhtme.



- b. tematikat që trajtohen në lëndën e gjuhës së huaj janë të larmishme dhe mbulojnë të gjitha fushat e jetës si psh:

- **Jeta e përditshme** (*koha e lire, aktivitetet e moshës, planifikimi i kohës, axhenda, sporti, ushqimet, të dhëna personale, plane personale etj.*)
- **Jeta shkollore** (*planifikimi i udhëtimeve me klasën, rregullat në shkollë, mësimi në shkollë etj.*)
- **Jeta personale dhe shoqërore** (*probleme të adoleshencës, festat, personaliteti, marrëdhëniet shoqërore, dëshirat etj.*)
- **Bota rreth nesh** (*udhëtimet dhe turizmi, kultura, kujdesja për planetin, çështje, përgjegjësitë shoqërore, komuniteti etj.*)
- **Bota e komunikimit** (*shkenca dhe teknologjia, shpikje dhe zbulime, telefoni, radio, muzika, çështje aktuale.*)

Realizimi i kompetencave kyçgjatë procesit të të nxënit, kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçe me kompetencat specifike të lëndës. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxëni. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi punon për të përmbushur kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe.

Mësuesi gjatë procesit të planifikimit të periudhave mësimore si edhe planifikimit ditor, duhet të jetë shumë i kujdesshëm në përcaktimin e rezultatit/eve të të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse. Mësuesi duhet t'i përshtasë ato me rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës duke përzgjedhur dhe përdorur përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike dhe metodologjinë e duhur përmes të cilave të realizojë sa më mirë këto rezultate.

Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet zhvillimit të kompetencave dhe njohurive të marra në lëndën e gjuhës së huaj nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

1. *Kompetenca digjitale dhe Gjuha e huaj.*

Gjatë prezantimeve të ndryshme në orën e gjuhës së huaj, nxënësi jo vetëm zhvillon kompetencën pragmatike (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve), por ai përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke ndihmuar në zhvillimin e kompetencës digjitale.

Mësuesi në lëndën e gjuhës së huaj mund të planifikojë veprimtari dhe ushtrime të ndryshme, ku nxënësi të zhvillojë kompetencën digjitale :

Shembull

Pasi është trajtuar tema gramatikore “Koha e tashme e thjeshtë (veta a tretë) në gjuhën angleze, mësuesi prezanton nxënësit me një ushtrim të shkruar në Word ku atij i duhet të zëvendësojë përemrin **I** (unë) me **she** (ajo) dhe si rezultat nxënësit do t’i duhet të ndryshojë edhe formën e foljes. Mësuesi jep udhëzime të qarta për të punuar në këtë dokument Word-i.

*“Replace “I” with “she” in the following passage. You can use **Find and Replace** for this task. (**Edit>Replace**) . Make any further changes as necessary.*

I come from Albania. I am 15 years old and study at school. I live in a small flat”

2. *Kompetenca e të nxënit dhe Gjuha e huaj.*

Rezultatet e të nxënit të kompetencave në lëndën e gjuhës së huaj, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Shembull

Një nga rezultatet e kompetencës kyçe të të nxënit për shkallën e dytë (klasa 5) është; *“nxënësiprezanton veten, shkollën, familjen, dëshirat, etj.,me fjali të mësuara paraprakisht”.*

Ky rezultat lidhet shumë mirë me njohuritë dhe konceptet që merr nxënësi po në këtë klasë: **Jeta personale dhe shoqërore**(*familja, anëtarët e familjes, mamaja, babai, motra, vëllai, shtëpia ime, dhoma ime e gjumit, dhomat e tjera, mobiljet, festat, pushimet, aktivitetet në kohën e lirë*).

3. *Kompetenca qytetare dhe Gjuha e huaj.*

Në programin e klasës IX (shkalla 4) një nga rezultatet e të nxënit të kompetencës qytetare (kompetencë kyçe) është *“nxënësi përcakton rregullat e punës në grup në bashkëpunim me anëtarët e grupit”.*

Shembull

Për përmbushjen e këtij rezultati mësuesi që në fillim të vitit shkollor zhvillon një orë mësimore duke u prezantuar nxënësve situatën e të nxënit “Puna në grup”. Për realizimin e kësaj situatë të të nxënit, nxënësit në grupe dhe në mënyrë të pavarur krijojnë një listë me 10 rregulla, që ata do të dëshironin të ndiqnin gjatë vitit sa herë që mësuesi do t’i vendosë të punojnë në grupe. Pasi përpilohet lista, mësuesi u kërkon nxënësve të prezantojnë listën e secilit grup dhe në fund të vendosin si klasë për listën përfundimtare. Kjo listë përgatitet si

poster nga nxënësit dhe ekspozohet në klasë ku nxënësit i referohen sa herë që punojnë në grupe. Mësuesi monitoron gjithë procesin dhe kërkon që rregullat të respektohen, pasi ato do të jenë edhe pjesë e kriterëve të vlerësimit të punës në grup.

4. *Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin dhe Gjuha e huaj.*

Në programin e klasës VIII (shkalla 4) një nga rezultatet e të nxënës të kompetencës për jetën, sipërmarrjendhemjedisin (kompetencë kyçe) është: *” nxënësi përgatit një autobiografi ku prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet, që ka për fusha të caktuara, si dhe profesionin e dëshiruar me fjali të thjeshta ”.*

Shembull

Mësuesi ndihmon nxënësin për përmbushjen e këtij rezultati kur trajton temën “Personalitete të shquara në fushat e ndryshme të jetës” ose “Profesionet” duke organizuar punën me role, ku nxënësit marrin pozicione të ndryshme dhe intervistojnë njëri-tjetrin për dëshirat, avantazhet dhe disavantazhet e një profesioni ose duke realizuar intervista të ndryshme pune etj. Mësuesi ndihmon nxënësit me fjalorin dhe me struktura të ndryshme formulimi fjalish.

Gjithashtu, e parë në kontekstin e anasjelltë, nxënësi ndihmohet nga kompetencat kyçe për të përmbushur sa më mirë kompetencat specifike të lëndës dhe për të realizuar veprimtaritë gjuhësore. Si p.sh në varësi të tekstit që nxënësi lexon, ai nuk bazohet vetëm tek kompetenca gjuhësore, por edhe tek kompetenca e të menduarit ose ajo qytetare. Në një rast tjetër nëse nxënësi lexon një tekst si pjesë e një programi të të mësuarit, ai bazohet te kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësi që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca, që ndihmojnë nxënësin në procesin e të nxënës në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuara në lëndët e tjera duke e ndihmuar nxënësin të zgjerojë fjalorin dhe të zhvillojë aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë. Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore, nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatiksht të saktë.

Më poshtë po renditim disa shembuj të integritit ndërlëndor të cilët nuk janë shteruese dhe

pasurohen nga vetë mësuesit në punën e tyre të përditshme sipas situatave të krijuara në çdo orë mësimi:

1. *Gjuha e huaj dhe gjuha shqipe*

Gjuha e huaj mundëson nxënësin që të kuptojë më mirë rregullat se si funksionon ajo gjuhë si edhe të bëjë krahasime midis gjuhës së huaj dhe gjuhës amëtare. Në lëndën e gjuhës së huaj nxënësi gjithashtu mëson të analizojë tekste dhe mesazhe të ndryshme. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve, marrëdhënieve dhe figurave historike si dhe vlerave shoqërore.

- a. *Shembull:* nxënësve u kërkohet të emërtojnë në gjuhë të huaj pjesët e ligjëratës në një fjali dheta përkthejnë fjalinë në shqip duke krahasuar më tej pozicionin e secilës pjese të ligjëratës.
- b. *Shembull:* Kur në orën e të shkruarit trajtohet tema “Përmbledhja e një tregimi”, mësuesi pyet nxënësit se cili është autori që ata po studiojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe u kërkon atyre të shkruajnë rreth një tregimi të atij autori me fjali të thjeshta. Mësuesi ndihmon me fjalorin (autori, personazhi kryesor, ngjarja zhvillohet ...) dhe strukturën e të shkruarit.

2. *Gjuha e huaj dhe historia, gjeografia e qytetaria.*

Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (*histori, gjeografi, qytetari* etj) nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë dhe gjithashtu fiton njohuri mbi vendet ku flitet gjuha e huaj, të cilën po mëson. Këto njohuri ndërthuren me dijet mbi kulturën e këtyre vendeve, zakonet e doket e tyre, mënyrën e jetesës etj. Nxënësi mëson të ndërveprojë në situata të ndryshme me sjellje etike të përshtatshme, të cilat trajtohen përmes funksioneve gjuhësore, si: të kërkojë falje, të pyesë etj.

- a. *Shembull:* Mësuesi u kërkon nxënësve të krijojnë një broshurë në gjuhë të huaj për qytetet kryesore historike të Shqipërisë. Për këtë arsye klasa ndahet në grupe (mund të jetë edhe projekt) dhe secilit grup i cakton një qytet për të pezantuar. (pozita gjeografike, traditat dhe gatimet tradicionale për atë qytet, historiku i shkurtër, monumentet kryesore kulturore).

3. *Gjuha e huaj dhe lëndët e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”*

Me këto lëndë janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat, ndotja, mbrojtja e ambientit etj., të cilat rekomandohen në Kuadrin e Përbashkët European të Referencave për Gjuhët. Këto tema shoqërohen me fjalor e

struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ në lidhje me nivelin përkatës.

- a. *Shembull:* nxënësve u kërkohet të shkojnë në një treg mallrash në qytetin e tyre ose në rrugën kryesore të qytetit, në të cilën ka shumë trafik. Nxënësit inkurajohen të vëzhgojnë dhe të mbajnë shënime për këtë veprimtari dhe me pas u kërkohet të krijojnë një poezi ose tregim të shkurtër duke përdorur imagjinatën bazuar në vëzhgimet e tyre.

4. *Gjuha e huaj dhe matematika*

Integrimi i gjuhës së huaj me lëndët brenda fushës si edhe të fushave të tjera, ndihmon jo vetëm në lidhjen ndër-lëndore, por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij në jetën e përditshme. Lidhja me *shkencat natyrore* p.sh.mematematikën, me gjuhën e huaj shprehet në të mësuarin e numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

- a. *Shembull:* mësuesi ndan klasën në grupe dhe secilit nxënës i jepet një rol i caktuar:
(a) Nëna dërgon dy djemtë e saj të blejnë fruta dhe perime dhe u jep një buxhet të caktuar për të shpenzuar si edhe një listë me artikujt që do të blejnë. Djemtë duhet të vendosin vetë se sa kg do të blejnë për secilin artikull duke parë çmimet dhe duke biseduar me shitësin. Ata duan të kursejnë lekë për të blerë edhe nga një akullorë secili.

5. *Gjuha e huaj dhe biologjia*

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti dhe mjedisi.

- a. *Shembull:* Në një orë gramatike me temë “Përemrat pronorë”, mësuesi mund ta lidhë shumë mirë me lëndën e biologjisë ku nxënësit përdorin përemrat në një kontekst të jetës së përditshme (a) duke përshkruar pjesët e trupit: Mësuesi ndan klasën në grupe dhe secili grup ose përshkruan një foto ose vizatojnë vetë njerëz në veprim ku fokusi do të jetë përdorimi i përemrave pronorë (Her hair is long. He is holding his hands in his pockets.) ose (b) mënyrat e ndryshme të ushqyerjes së pjesëtarve të familjes. (My sister eats healthy. Her breakfast consists of ...; His brother often eats junk food. etc)

6. Gjuha e huaj dhe artet

Tema të tilla si sporti, muzika, moda, piktura etj, janë të lidhura ngushtë me fushën e arteve ku nxënësit shkruajnë dhe diskutojnë rreth biografisë ose karrierës së aktorëve, sportistëve etj., të tyre të preferuar.

- a. Shembull: në një orë rimarrje njohurish kur nxënësi ka mësuar ngjyrat , mbiemrat dhe kohën e tashme të vazhduar mësuesi prezanton nxënësit me dy foto ku në njërin luhet futboll European dhe në tjetrën futboll amerikan. Mësuesi u kërkon nxënësve të përshkruajnë fotot dhe i ndihmon ata me fjalor.



Europe	USA
They are playing football. The ball is round and white and black.....	They are playing football too but the ball is not round. It is

- b. Shembull: Në një orë ku si rezultat i të nxënit është zhvillimi i aftësisë së të folurit, mësuesi u kërkon nxënësve të zgjedhin aktorin, autorin, sportistin, këngëtarin etj., e tyre të preferuar dhe të prezantojnë jetën dhe karrierën e tij/saj. Nxënësi prezanton në vetën e parë ose në atë të tretë nëse fokusi është përdorimi i foljes në vetën e tretë njëjës.

7. Gjuha e huaj dhe TIK

Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, e-mail-in, programe të ndryshme, platforma digjitale, aplikacione etj, jo vetëm që e ndihmon nxënësin të marrë informacionin në kohë reale, por gjithashtu e ndihmon atë të eksplorojë të rejtat mbi

botën dhe lëndën që ai po studion, të prezantojë sa më bukur dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij.

- a. *Shembull:* Mësuesi u jep nxënësve detyra me shkrim ku ata mund të përdorin aftësitë e tyre të marra në lëndën e TIK. Mësuesi përcakton dy grupe (Grupi A dhe Grupi B) të cilat do t'i dërgojnë e-mail njëri-tjetrit dhe do të bëjnë CC mësuesin. (Grupi A: Mësuesja kujdestare ju ka caktuar të organizoni një eskursion. Shkruajini një e-mail shokut tuaj ku t'i përshkruani planin tuaj dhe t'i kërkon ndihmë me organizimin; Grupi B: Sa keni marrë një e-mail nga shoku juaj i cili ju përshkruan planin për organizimin e një ekskursionit si edhe ju kërkon ndihmë. Kthejini përgjigje shokut tuaj.)

Gjithashtu përvetësimi i mirë i gjuhës së huaj ndihmon nxënësin të zhvillojë më tej punën e tij kërkimore në fushat e tij të interesit (histori, shkencë, matematikë etj) pasi shumë materiale gjenden në gjuhë të huaj.

V. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIE – NXËNIES NË GJUHË TË HUAJ

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyçe dhe ato të lëndës.

Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën e përditshme dhe botën e punës.

Ky përditësim do t'i ndihmojë mësuesit gjithashtu për të reflektuar rreth mësimdhënies së tyre si edhe të vlerësojnë pikat e tyre të forta dhe të dobta. Mësuesit që njohin dhe përdorin teknika të ndryshme në orën e mësimit pa dyshim janë shumë efektiv si edhe adoptohen më lehtë me nevojat e nxënësve dhe me situata të ndryshme me të cilat mund të ndeshen në klasë.

Një nga kompetencat kyçe në Kurikulën me bazë kompetencat është kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kjo sjell si detyrë kryesore të çdo mësuesi të gjuhës së huaj që duke mos lënë mënjanë metodat e mëparshme që ka përdorur (Grammar Translation Method, Audio- Lingual Method, Total Physical Response Method etc) të përdorë gjerësisht metodën komunikative në mësimdhënie (Communicative Language Teaching Method). Qëllimi i kësaj metode është që në orën e mësimit gjuha që përdoret të jetë sa më afër gjuhës që përdoret në jetën e përditshme. Kjo

do të thotë që mësuesi duhet t'i mësojë nxënësit jo “si të flasin” por “çfarë të flasin” dhe “kur të flasin”.

Disa tipare të kësaj metode janë:

- mësuesi dhe nxënësit përdorin gjuhën që po mësojnë gjatë orës së mësimit;
- gjuha që nxënësit po mësojnë është një mjet për komunikimin në klasë rreth problemeve dhe çështjeve reale të jetës së përditshme;
- funksionet gjuhësore që mësohen përdoren në situata të nxëni të shumëllojshme dhe reale;
- veprimtari të përditshme janë puna në çift, puna me role dhe lojrat pasi ato ngjasojnë me botën reale gjuha që përdoret duhet të ketë një qëllim;
- theksi vendoset në diskutimin e situatave reale, ku shprehjet dhe fjalori i ri që po jepet, është i përshtatshëm për këto situata.
- gabimet konsiderohen të natyrshme dhe të pranueshme.

Nxënësit ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri, por dy faktorë duket se janë universalë: Nxënësit mësojnë kur 1) ata motivohen dhe 2) kur nuk kanë ankth.

Tabela e mëposhtme jep veprimtari të ndryshme që mund të përdoren me nxënës të ndryshëm.

Nxënësi dinamik	Nxënësi me imagjinatë	Nxënësi analitik	Nxënësi praktik
Përshkrimi			
Është i interesuar të zbulojë vetë informacionin dhe i pëlqejnë metoda të ndryshme në orën e mësimit. Mëson duke provuar dhe gabuar.	I pëlqen diskutimi, puna në grup, jep feedback, realist rreth ndjenjave dhe përdor imagjinatën e tij në trajtimin e problemeve. Mëson duke dëgjuar dhe duke shkëmbyer ide.	Është i interesuar në fakte. I pëlqejnë detajet dhe mendimi i organizuar. Mëson më mirë kur i trajton problemet nëpërmjet ideve.	Është i interesuar se si funksionojnë gjërat. I pëlqejnë gjërat teknike dhe aktivitetet praktike. Mëson më mirë kur i aplikon teorinë në praktikë.
Llojet e veprimtarive			
<ul style="list-style-type: none"> • Shkrim letrash. • Përgatitje posterash. • Lojra të ndryshme. • Fjalime. • Pjesëmarrje në 	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutim rreth përvojave personale • Diskutim rreth pikturave, posterave, vizatimeve etj. • Stuhi mendimesh. 	<ul style="list-style-type: none"> • Analizë faktesh • Leksione • Marrje shënime • Ushtrime të kontrolluara. • Lexim në qetësi. 	<ul style="list-style-type: none"> • Formulim pyetjesh rreth mësimit. • Ushtrime që kërkojnë aftësi të menduarit kritik. • Ushtrime me

<p>skenarë të ndryshëm në lojën me role.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Publikim i punimeve të nxënësve. • Organizimi i ekskursioneve tematike. • Intervista. • Pyetsorë dhe vëzhgime. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të dëgjuarit. • Të kënduarit e një kënge. • Intervistat. • Leximi i një artikulli të shkurtër, gazete/ tekst kënge/ poemë. • Shkëmbimi i një modeli detyre. 	<ul style="list-style-type: none"> • Diktimit. • Analizë diagraresh, tabelash etj. 	<p>alternative/kombini me</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diskutime në çift ose në grup. • Planifikimi i projekteve. • Ushtrime me hapësira bosh. • Tregime të animuar. • Krijim diagraresh, tabelash etj
--	---	--	---

Mësuesit gjithashtu duhet të marrin në konsideratë stilet e të nxënësve dhe veprimtaritë që lidhen me secilin prej tyre.

Stili i të nxënësve	Karakteristikat	Veprimtaritë që rekomandohen
Visual (visual)	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • preferon të përdorë imazhe, foto, vizatime, harta, grafikë për të kuptuar informacionin e ri. • përdor shprehje “më trego....” “le të shikojmë ...” • e kryen detyrën më mirë pasi ka parë udhëzimet ose pasi shikon një person tjetër që performon më përpara. 	<ul style="list-style-type: none"> • përdorimi i hartave, grafikëve për prezantimin e njohurive të reja. • nënvizimi i koncepteve të reja. • përdorimi i listave, flash cards për rimarrjen e njohurive. • përdorimi i figurave për prezantimin e fjalëve të reja. • shkrimi në dërrasë i informacionit dhe koncepteve kryesore. • nëse punon në kompjuter, të rekomandohet të përdorë fonte dhe ngjyra të ndryshme në organizimin e informacionit.
Auditiv (auditory)	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton informacionin e ri më mirë kur e dëgjon ose kur e diskuton në grup. • përdor përsëritjen si një teknikë 	<ul style="list-style-type: none"> • përfshirja e nxënësit në diskutime rreth temës së dhënë. • pyetje për nxënësit rreth materialit. • nxënësit bëjnë përmblendhjen e mësimit.

	<p>e të nxënësve dhe përfiton nga përdorimi i teknikave të mbajturit mend (mnemonic devices).</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor shprehje si “le ta bisedojmë ...” “le të flasim rreth...” • kryen detyrën më mirë kur i jepen udhëzime me gojë. 	<ul style="list-style-type: none"> • inkurajimi i nxënësve të regjistrohen kur mësojnë njohuritë dhe konceptet e reja. • leximi i tekstit me zë të lartë. • nxënësve sugjerohet të lexojnë disa herë me zë të lartë.
Prekshëm/kinestetik (kinesthetic/tactile)	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton informacionin e ri më mirë kur i prezantohet nëpërmjet lëvizjes; • mëson më mirë kur e krijon vetë një detyrë dhe ka preference për përvoja fizike; • përdor shprehje si “le ta provojmë...” “si ndiheni..” • kryen detyrën më mirë kur provon vetë dhe mëson duke bërë; • pëlqen eksperimentet dhe nuk i referohet udhëzimeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Dhënia e listës së materialeve që do duhen për një veprimtari. • Përdorimi i llojeve dhe formateve të ndryshme fletë pune, lapsash etj. • Përdorimi i koncepte të punës me role ose në grup. • Prezantimi i konceptit të ri nga nxënësi nëpërmjet lëvizjes. • Krijimi nga nxënësit i skenareve për përdorimin e koncepteve të reja. • Vendosija e nxënësve në role të ndryshme. • Inkurajimi i nxënësve për të përdorur lëvizjet trupore kur mëson koncepte të reja.
Linguistik/ verbal (read and write)	<ul style="list-style-type: none"> • preferon të lexojë dhe të shkruajë; • prezanton veten si adhurues i të lexuarit dhe që mban shumë shënime; • është në gjendje të shpjegojë konceptet abstrakte me fjalë ose edhe të shkruajë ese; • mëson më mirë kur i jepen ushtrime që kanë të bëjnë me arsyetimin gjuhësor. 	<ul style="list-style-type: none"> • organizimi i lojrave gjuhësore; • projekte të bazuara në të shkruarin; • caktimi i detyrave që fokusohen tek analiza letrare e tekstit; • vizita në librari, biblioteka; • nxënësit inkurajohen të hartojnë fjalorët e tyre; • tregimi nga nxënësit i historive që kanë lexuar; • punimi i ushtrimeve me fjalorin dhe të lexuarin e tekstit.

Mësuesi në punën e tij duhet të përdorë veprimtari, teknika dhe strategji të larmishme për t'iu përshtatur stileve të ndryshme të të nxënësve dhe duke e bërë orën e mësimit sa më interesante dhe motivuese për nxënësin.

Më poshtë po listojmë disa teknika dhe aktivitete të ndryshme të cilat mund të përdoren në orën e mësimit:

1. **Eliciting** (nxjerrja e informacionit nga vetë nxënësit): është një term që përfshin disa teknika të cilat e aftësojnë mësuesin për të inkurajuar nxënësit të japin vetë informacion duke mos e marrë atë gati nga mësuesi.

Eliciting ndihmon për të patur një klasë me në qendër nxënësin dhe krijimin e njohurive të reja mbi njohuritë që nxënësi ka. Eliciting është një teknikë bazë që duhet të përdoret rregullisht dhe jo vetëm në fillim të orës së mësimit, por kurdo që është e domosdoshme.

Mësuesi mund të marrë informacion nga nxënësit (elicit) për çdo gjë në orën e mësimit: fjalor, gramatikë, përvoja, ide etj.

Disa mënyra efektive për të marrë informacion nga nxënësit (eliciting) jepen në shembujt e mëposhtëm:

Shembull

- a. Mësuesi pyet “What is another way to say _____ ? Si mund ta themi ndryshe _____? (T: “What is another way of saying I am very very hungry?” S:” I am starving.”)
 - b. Nëse nxënësi nuk e di fjalën e re mësuesi jep një përkufizim të thjeshtë të asaj fjale: “It is something that we drink hot coffee and tea with (a mug)”
 - c. Mësuesi përdor lëvizje dhe mimikën për shpjegimin e fjalëve.
 - d. Mësuesi përdor mjete vizuale.
2. **Dialogu**: Nëpërgjithësi dialogu përdoret për të ndihmuar nxënësin të mbajë mend struktura të reja dhe fjalorin e sapo mësuar. Dialogu mund të meret nga teksti, mund ta ketë përgatitur mësuesi ose vetë nxënësit duke ndjekur një model të dhënë.

Shembull

- a. Nxënësit lexojnë dialogun në qetësi.
- b. Në çifte ose në grupe nxënësit praktikojnë dialogun në fillim duke lexuar dhe më pas duke e mbajtur mend.

- c. Nxënësit e zgjerojnë ose e ndryshojnë dialogun duke e përshtatur sipas situatave të tyre personale.
- 3. Loja me role:** Nxënësit marrin role të ndryshme dhe më pas ju jepet kohë të mendojnë duke pretenduar se janë personazhi rolin e të cilit kanë marrë. Kjo teknikë përdoret për të ndihmuar nxënësin që ta konsiderojë një problem nga këndvështrime të ndryshme. Loja me role mund të funksionojë shumë mirë duke pasuar dialogun ku nxënësit marrin rolet e personazheve në dialog dhe krijojnë dialogun e tyre.
- Mësuesi krijon situatën për lojën me role
 - Nxënësve ju jepet një rol dhe koha e duhur për të menduar për rolin.
 - Zhvillohet debat ose diskutim midis nxënësve sipas roleve.
 - Nxënësit jashtë rolit të tyre diskutojnë për procesin se si u zhvillua debate.
- 4. Pyetsor ose studim çështjeje:** Kjo teknikë ndihmon nxënësin të formulojë pyetjet dhe të mbledhë informacionin e duhur duke nxitur pavarësinë dhe autonominë e tij në procesin e të nxënësve. Gjithashtu kjo teknikë ndihmon krijimtarinë dhe bashkëveprimin midis nxënësve.
- Mësuesi shpjegon informacionin që do të mblidhet.
 - Nxënësit individualisht, në çift ose në grup hartojnë pyetjet e pyetsorit për të mbledhur informacionin që u duhet.
 - Të dhënat e pyetsorit përpunohen në klasë.
 - Rezultatet diskutohen në klasë.
- 5. Diskutimi në grupe të vogla:** Kjo teknikë përdoret kur mësuesi do të inkurajojë pjesëmarrjen e nxënësve në klasë dhe gjithashtu ndihmon në mbledhjen e opinionëve dhe ideve të nxënësve si edhe të ulë ankthin e nxënësit për të folur para një publiku të gjerë. Gjatë aplikimit të kësaj teknike mund të krijohet zhurmë në orën e mësimit e cila është e justifikueshme në klasat e gjuhëve të huaja.
- Mësuesi prezanton temën.
 - Formohen grupet dhe jepen pyetje për secilin grup.
 - Grupet marrin kohë mjaftueshëm për të diskutuar dhe debatuar për temën e dhënë.
 - Ndahen opinionet dhe përgjigjet e pyetjeve me të gjithë klasën.

Mësuesi përdor strategji të ndryshme për ndarjen e klasës në grupe ose çifte:

Shembull

- Grupimi i nxënësve sipas interesave: Nëse në një temë mësimi nxënësit do të diskutojnë për sportet e ndryshme dhe për avantazhet dhe disavantazhet e secilit prej


tyre, mësuesi i ndan nxënësit në grupe sipas pëlqimit të secilit nxënës. Grupi A: të gjithë ata nxënës që pëlqejnë ose praktikojnë basketbollin; Grupi B: të gjithë ata nxënës që pëlqejnë çiklizmin etj)

- b. Grupimi i nxënësve sipas ngjyrës së tyre të preferuar: Mësuesi përdor letra ose lapsa me ngjyra të ndryshme për secilin grup dhe nxënësi zgjedh të bashkohet me grupin i cili përfaqëson ngjyrën e tij të preferuar.
- c. Grupimi i nxënësve sipas ditëlindjes së tyre: Mësuesi u kërkon nxënësve të gjejnë shokët ose shoqet të cilët kanë lindur në të njëjtin muaj me të për të krijuar grupin e tyre.

6. **Brainstorming** (Stuhi mendimesh), është një teknikë pune në grup ku secili nxënës përpiqet të gjejë një zgjidhje, të arrijë në një konkluzion për një problem të caktuar ose të gjenerojë ide të reja.

- a. Nxënësit inkurajohen të mendojnë dhe shprehen lirshëm.
- b. Të gjitha idetë listohen në dërrasë ose organizohen në harta semantike dhe nuk kritikohen.
- c. Kur janë shprehur të gjitha idetë bëhet vlerësimi i secilës prej tyre nga nxënësit duke diskutuar më në detaje.
- d. Mësuesi monitoron dhe ndihmon me fjalor dhe saktësim konceptesh.

7. **Harta semantike**-Harta semantike është një organizim grafik që i ndihmon nxënësit të organizojnë idetë e tyre si klasë, në grup ose individualisht. Në lëndën e gjuhës së huaj harta semantike përdoret për të zgjeruar fjalorin dhe për t'i grupuar fjalët në kategori që lidhen me njëra-tjetrën. Një organizues shpesh shoqërohet me ide dhe është i dobishëm për lidhjet midis ideve dhe koncepteve duke u bazuar në njohuritë e marra për të ndërtuar njohuri dhe koncepte të reja ose për të zgjeruar fjalorin mbi një temë të caktuar. Organizuesit semantikë zakonisht kanë një koncept qendror që rrethohet nga koncepte të tjera kyçe që e zbërthejnë atë dhe që mund të bëhen edhe



më të hollësishme, sa më shumë që largohen nga koncepti qendror.

Shembull

Në temën mësimore “Mjetet e transportit” mësuesi mund të përdorë hartën semantike të mëposhtme për të mbledhur informacion nga nxënësit.

8. *Think-Pair-Share (TPS)*- është një teknikë që mësuesi përdor, kur nxënësit duhet të zgjidhin një problem së bashku ose kur nxënësit duhet të dalin me një përgjigje të përbashkët për një pyetje.

- a. Secili nxënës mendon në mënyrë individuale ose shkruan përgjigjen e pyetjes në fletore (think)
- b. Mësuesi i vendos nxënësit në çifte ku ata diskutojnë për përgjigjet e tyre (pair)
- c. Nxënësit ndajnë mendimet e tyre me të gjithë klasën dhe dalin në konkluzione të përbashkëta (share).

Shembull

Një teknikë shumë e mirë për të ndarë nxënësit në çifte është përdorimi i sinonimeve ose të kundërtave të një fjale. Mësuesi përgatit fletë ku në secilën prej tyre është shkruar një fjalë. Nxënësve u jepet kohë të gjejnë shokun/shoqen që ka fletën ku është shkruar sinonimi ose e kundërta e fjalës që ka fleta e tij dhe kështu ai/ajo gjen shokun/shoqen me të cilin do të diskutojë përgjigjet e pyetjes së dhënë.

9. *Know-Want to know-Learned (KWL)* (Di-Dua të di-Mësova)- është teknikë e cila i ndihmon nxënësit të organizojnë informacionin përpara, gjatë dhe pas një ore mësimi. Mësuesi e përdor këtë teknikë për të inkurajuar nxënësit të jenë sa më aktivë në marrjen e njohurive të reja, në shkëmbimin e rezultateve të të nxënësve si edhe për monitorimin e procesit të të nxënësve.

- a. Nxënësit krijojnë tabelën K-W-L
- b. Nxënësit plotësojnë kolonën e parë (What do you know about this topic?- çfarë dini rreth kësaj teme?). Nxënësit punojnë individualisht ose në çifte. Ndonjëherë mësuesi krijon një listë në dërrasë të të gjitha përgjigjeve të nxënësve. Në këtë fazë mësuesi mund të korrigjojë konceptet e gabuara ose mund ta lërë si detyrë për nxënësit në fund të orës së mësimi.
- c. Nxënësit plotësojnë kolonën e dytë (What do you want to know about this topic?, Çfarë dëshironi të mësoni rreth kësaj teme?)

- d. Gjatë orës së mësimimit ose në fund të orës së mësimimit, nxënësit plotësojnë kolonën e tretë. Gjithashtu nxënësit mund të shtojnë pyetje të tjera tek kolona e dytë, të cilat mund të shërbejnë si fillim për orën tjetër të mësimimit.

Shembull

Topic: Films/Batman		
What I know	What I want to know	What I have learned
<ul style="list-style-type: none"> • Batman is a superhero who dresses like a bat. • Batman`s sidekick is named Robin. • Batman fights crime in Gotham City • Batman real name is Bruce Wayne 	<ul style="list-style-type: none"> • Who created Batman? • Is Batman friend with Superman? • Is Gotham City a real place? • Why did Bruce Wayne become Batman? 	<ul style="list-style-type: none"> • Batman was created by Bob Kane. • Gotham City is a fictional place, but Gotham City is also nickname for New York City. • Bruce Wayne`s parents were murdered by a crook.

10. Të mësuarit me projekte - Projekti kurrikular në lëndën e gjuhës së huaj është rubrikë e detyruar e **Portofolit Europian të Gjuhëve**.

Projekti kurrikular është strategji e të nxënimit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit kritik, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.

Zbatimi i një projekti në lëndën e gjuhës së huaj kërkon më shumë se një orë mësimore.

Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe vetëm brenda një periudhe. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është dicka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.

Nëse projekti ka shtrirje përgjatë gjithë vitit, në çdo periudhë vlerësohet si pjesë e portofolit ajo pjesë e projektit që është realizuar. Në rastin kur ka shtrirje brenda një periudhe vlerësohet i gjithë projekti.

Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efektive i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme duke integruar edhe fushat dhe lëndët e tjera të të nxënësve.

Realizimi i një projekti në lëndën e gjuhës së huaj kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike ose strategjie, si: vrojtimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale etj.

Hapat kryesore që ndiqen për realizimin e një projekti janë:

- Përcaktohet saktë çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë. Nxënësit mund të bazohen tek temat mësimore, interesat, dëshirat ose pasionet e tyre etj.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
- Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar. Për prezantim nxënësit mund të përdorin mënyra të ndryshme si: *PowerPoint*, film, dramatizim, debat, gazetë, broshurë, guidë etj.

Për planifikimin e një projekti mësuesi në bashkëpunim me nxënësit ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Ky plan ju paraqitet nxënësve të cilët e realizojnë atë gjatë gjithë vitit. Projekti shkruhet në gjuhën e huaj të cilën nxënësit po mësojnë.

Mësuesi planifikon në planin e tij ditë për ditë çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular përfshijnë:

1. Tema e projektit:

Përcaktohet nga nxënësit në bashkëpunim dhe monitorim nga mësuesi. Klasa ndahet në grupe dhe secili grup zgjedh temën duke u bazuar në temat të cilat do të zhvillohen gjatë vitit si dhe duke pasur parasysh integrimin me lëndët e tjera.

2. Kohëzgjatja e projektit/orët mësimor:

Nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohet kontributi i çdo mësuesi dhe orët mësimore për secilën lëndë. Këshillohet që projekti të jetë për gjatë gjithë vitit pasi nxënësit duhet të kenë kohë të hulumtojnë, diskutojnë dhe të dalin me një produkt final. Në lëndën e gjuhës së huaj projekti nuk duhet të jetë më pak se 8 orë.

3. Klasa/t pjesëmarrëse:

Përcaktohet klasa ose klasat në rast se ka disa klasa. Lënda e Gjuhës së huaj krijon hapësirën dhe mundësinë të ketë bashkëpunim midis klasave dhe lëndëve të ndryshme.

4. Rezultatet e të nxënit:

Përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të zhvillohen përmes veprimtarive të projektit. Këto rezultate merren nga PEGJ –Portofoli European iGjuhëve ku janë të detajuara për secilën aftësi dhe nivel në formën e fjalive “Unë mund të bëj “ (rezultatet dhe i gjithë projekti do të shkruhen në gjuhën e huaj që nxënësi po mëson.)

Shembull

Ne mund të:

- analizojmë faktorët dhe pasojat
- paraqesim në forma të ndryshme (me gojë, me të shkruar) argumente për të përforcuar mendimet apo qëndrimet tona
- realizojmë vëzhgime në rajonin (qytetin/fshatin) ku jetojmë të
- realizojmë individualisht ose në grup intervista, biseda me specialistë mbi
- kërkojmë në burime të ndryshme informacioni, mbledhim informacion, dhe prezantojmë informacionin e përpunuar me anë të tabelave, diagrameve, grafikëve, tekstit të shkruar etj.
- përgatisim një plan veprimtarish/masash për nxënësit e shkollës/ klasës sonë, të cilat do të ndikojnë

- bashkëpunojmëdhe ndajmë ide me shokët për realizimin e projektit.
-

5. Njohuritë kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

Përcaktohen konceptet dhe njohuritë që duhet të zotërojë nxënësi për realizimin e këtij projekti.

6. Partnerët

Përcaktohen partnerët nëse ka, p.sh. nëse projekti në lëndën e Gjuhës së huaj ka si qëllim që nxënësit të hulumtojnë për ndotjen mjedisore në zonën ku banojnë, një specialist i mjedisit mund të jetë një partner pjesëmarrës në projekt.

7. Veprimtaritë kryesore që do të kryen për realizimin e projektit, afatet dhe personat përgjegjës:

Klasa ndahet në grupe dhe secili grup në bashkëpunim me mësuesin përcaktojnë afatet kohore.

Shembull

Nr	Veprimtaria	Afati	Produkti i punës
----	-------------	-------	------------------

1	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i temës dhe nëntemave të projektit në bashkëpunim me nxënësit. • Përcaktimi i detyrave për secilin grup dhe nxënës. • Përcaktimi i afateve për secilën fazë të projektit. • Hartimi i një liste paraprake të burimeve të informacionit të cilët do të mbështesin studimin. • Përgatitja e pyetësorëve dhe intervistave të strukturuar. 	<p>Periudha e parë shtator-dhjetor, faza e parë e projektit.</p>	<p><u>Produkti:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi dhe dorëzimi nga çdo nxënës i dokumentit që pasqyron: <i>Temën e grupit, nënçështjen individuale, burimet e informacionit ku do mbështetet dhe hapat për fazat pasardhëse.</i> • Pyetësorët e përgatitur sipas tematikave të grupeve.
2	<ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja e informacionit nga pyetësorët, intervistat, dhe përmes hulumtimit në burimet e identifikuar të informacionit. • Përpunimi i të dhënave. • Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij. 	<p>Periudha e dytë janar-mars, Faza e dytë e projektit</p>	<p><u>Produkti:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Drafti i parë i projektit.
3	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e produktit përfundimtar. • Prezantimi nga grupet. • Vlerësimi i punës në grup dhe punës individuale 	<p>Periudha e tretë prill-qershor Faza e tretë e projektit</p>	<p><u>Produkti:</u></p> <p>Produkti përfundimtar në formën e një raporti.</p>

Shënim: Për projektin në gjuhë të huaj mund të organizohen edhe shfaqje të ndryshme ose dramatizime dhe si rezultat veprimtaritë dhe produkti do të jenë të ndryshme.

8. Burimet kryesore të informacionit -Mësuesi duhet të orientojë nxënësit drejt përdorimit të burimeve të larmishme dhe të duhura të informacionit. Në lëndën e Gjuhës së huaj ku temat që mund të zgjidhen janë nga të gjitha fushat e jetës, burime të çmuara informacioni, përveç internetit, teksteve të ndryshme si enciklopeditë, revistat, etj., janë vëzhgimet në natyrë dhe shoqëri, pjesëmarrja në punë komunitare dhe vullnetare etj.

9. Tematika e orëve të planifikuara të planit mësimor - këtu vendoset tematika për çdo orë mësimore të projektit. Psh: nëse projekti planifikohet në 8 orë atëherë duhet vendosur tematika për të tetë orët si ndarja e nxënësve në grupe, përcaktimi i temës dhe roleve për secilin grup, kërkimi dhe mbledhja e materialeve, krijimi i draftit të parë, prezantimi etj)

Shembull:

Tematika e orëve të planifikuara

- Ndarja e grupeve detyrave për secilin nxënës dhe përcaktimi i burimeve të informacionit.
- Hartimi i planit të veprimtarive të projektit për secilin grup, afatet dhe personi përgjegjës.
- Përgatitja e instrumenteve (pyetësorë, intervista) për grumbullimin e informacionit në terren.
- Grumbullimi i të dhënave nga intervistat dhe burimet e tjera të informacionit.
- Përpunimi i të dhënave. Diskutimi në klasë i rezultateve kryesore paraprahe të nxënësve.
- Përgatitja e draftit të parë të projektit dhe diskutimi në klasë.
- Prezantimi i produktit/raportit përfundimtar. Vlerësimi i punës në grup dhe individuale. (Prezantimi i produktit mund të kërkojë më shumë se një orë mësimore)

10. Përshkrimi i produktit të projektit -duhet të përfshijë shkurtimisht llojin e produktit që pritet të realizohet dhe mënyrën e prezantimit të tij.

11. Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi -Mësuesi së bashku me nxënësit përcaktojnë kriteret për vlerësimin e projektit të cilati komunikohen nxënësit që në fillim të projektit. P.sh. kriteret mund të përcaktohen në lidhje me trajtimin e përmbajtjes, në përmbushje të tematikës, përdorimin e burimeve të informacionit, përgatitjen e produktit, prezantimin e tij etj.,(në varësi të rezultateve të të nxënësit.)

Tabelat e mëposhtme paraqesin shembuj kriteresh për vlerësimin e projektit

Shembull 1

A është fokusuar përmbajtja e projektit te çështja/problemi i identifikuar për shqyrtim?	
A është lidhur tema e projektit me situata nga jeta reale?	
A i kanë zbatuar nxënësit konceptet e marra në lëndën përkatëse?	
A kanë mbledhur të dhëna bazuar në burime të mjaftueshme informacioni?	
A kanë bashkëpunuar nxënësit për të zhvilluar aftësitë komunikuese, vetmenaxhuese dhe organizuese?	
.....	

Shembull 2

Periudha	Kriteri	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
Periudha 1	<ul style="list-style-type: none"> Strukturon pyetësorët/intervi stat në përmbushje të tematikës dhe mbledhjes së të dhënave. 	Formulon pyetje të cilat nuk e adresojnë problemin konkret dhe grumbullimin e të dhënave.	Formulon pyetje që adresojnë pjesërisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave.	Formulon pyetje që adresojnë tërësisht problemin dhe mundësojnë grumbullimin e të dhënave.
		2 pikë	4 pikë	6 pikë
	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon dhe përdor burime të larmishme për hulumtimin e informacionit. 	Përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit.	Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit pa vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.	Identifikon dhe përdor burime të ndryshme për hulumtimin e informacionit duke vlerësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre.
		2 pikë	4 pikë	6 pikë
	<ul style="list-style-type: none"> Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup. 	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës.	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë.	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët.
		1 pikë	2 pikë	3 pikë
Pikët maksimale		15 pikë		
	<ul style="list-style-type: none"> Përpunon informacionin e mbledhur bazuar në të dhëna. 	Identifikon informacionin dhe të dhënat gjeografike për të nxjerrë përfundime të thjeshta.	Përkraan informacionin dhe të dhënat gjeografike për të nxjerrë përfundime bazuar në të dhëna.	Analizon dhe interpreton informacionin dhe të dhënat gjeografike për të nxjerrë përfundime dhe evidentuar kufizimet.
		2 pikë	4 pikë	6 pikë
	<ul style="list-style-type: none"> Organizon draft- 	Strukturon	Strukturon raportin	Strukturon raportin në





Periudha 2	produktin në përmbushje të tematikës dhe zgjidhjes së problemit.	raportin në çështje që adresojnë pjesërisht problemin, por nuk ofrojnë zgjidhje.	në çështje që adresojnë pjesërisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje të pjesshme.	çështje që adresojnë tërësisht problemin dhe ofrojnë zgjidhje.
		2 pikë	4 pikë	6 pikë
	• Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup.	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës.	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë.	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët.
		1 pikë	2 pikë	3 pikë
Pikët maksimale		15 pikë		
Periudha 3	• Trajton tematikën në funksion të zgjidhjes së problemit.	Identifikon zgjidhje për çështjen gjeografike aktuale pa u thelluar në pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.	Propozon zgjidhje për çështjen gjeografike aktuale dhe identifikon disa ndër pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.	Propozon zgjidhje për çështjen gjeografike aktuale dhe analizon pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.
		2 pikë	4 pikë	6 pikë
	• Prezanton informacionin duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm gjeografik.	Organizon me vështirësi informacionin, pa e përshtatur për audiencën e synuar.	Organizon informacionin, pa e përshtatur atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor fjalorin dhe terminologjinë gjeografike.	Organizon informacionin, e përshtat atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; përdor fjalorin dhe terminologjinë gjeografike.
		2 pikë	4 pikë	6 pikë
	• Shkëmben ide dhe bashkëpunon në grup për prezantimin e produktit përfundimtar	I bashkohet grupit por nuk është aktiv në realizimin e detyrës.	Bashkëpunon me grupin vetëm kur i kërkohet nga anëtarët e tjerë.	Demonstron gatishmëri për realizimin e detyrës dhe ndan ide me të tjerët.
		1 pikë	2 pikë	3 pikë
Pikët maksimale		15 pikë		

Në lëndën e gjuhës së huaj mësuesi përdor tabela të ndryshme vlerësimi të cilat i harton vetë sipas kompetencave, aftësive ose njohurive që do të vlerësojë.

Më poshtë po prezantojmë disa tabela sugjeruese vlerësimi:

Gjuhë angleze

Rubric 1

Student name: _____		Date: _____			
This project shows that the student:		4 	3 	2 	1 
1	Followed directions				
2	Understood new concepts				
3	Stayed on topic				
4	Used creativity; did not copy				
5	Used good craftsmanship				
6	Has a good composition				
7	Used time wisely; finished the project				
8	Used art materials correctly				
Total possible points: 32 Total points earned: ____		Comments:			

Gjuhë frënge

Grille d'évaluation d'un projet et du devoir du dossier de l'élève

Le professeur peut garder cette grille ou dresser lui-même une grille en fonction de ce qu'il va évaluer

Modèle 1

Sujet du projet	Points accordés (Totalité)	Groupe 1	Groupe 2	Groupe 3	Groupe 4
Organisation du groupe	4 points				
Participation individuelle	4 points				
Intérêt originalité	4 points				
Utilisation du lexique	4 points				

Travail rendu à temps	4 points				
Totalité	20 points				

Modèle 2

Grille d'évaluation du dossier

Nom _____ Prénom _____ Classe _____




Devoir 1	1 point	2 points	3 points	4 points
Originalité				
Correction grammaticale				
Richesse sociolinguistique				
Effort				
Esthétique				
Total _____/20				

Modèle 3

Projet de classe

Ces femmes hors commun qui ont marqué l'histoire de l'humanité

Auto-évaluation

	Bravo 	Travailler plus 	Pas content de mon travail 
J'ai participé activement à la conception du projet			
J'ai participé aux étapes techniques			
J'ai travaillé en équipe et j'ai respecté les points de vue des autres			
J'ai bien effectué la tâche donnée			
Je suis satisfait du produit final			

Modelet e mësipërme tregojnë që mësuesi është i lirë të vendosë vetë se cilat janë momentet kryesore që dëshiron të vlerësojë në një projekt. Në përcaktimin e kritereve të vlerësimit mësuesi përfshin edhe nxënësit në fillim të vitit shkollor dhe hartojnë së bashku rubrikat e vlerësimit.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri

Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit nxit motivimin dhe përmirëson të nxënit e drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobta dhe të forta, në mënyrë që të fokusojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme. Dokumenti mbi të cilin duhet të mbështeten nxënësit për vetvlerësim është Portofoli European i Gjuhëve.

Nxitja e nxënësit për t'u përfshirë në vendosjen e kritereve për vlerësimin e punës së tij e kalon një pjesë të përgjegjësisë tek nxënësi. Kjo ndjeshmëri e përdorur me më shumë theks te zhvillimi i nxënësit dhe vetëkuptimi, krahasuar thjesht me qëllimin për të arritur tek një notë, bën që vetëvlerësimi të kontribuojë në mundësitë e nxënësit për të strukturuar procesin e tij të të nxënit. Kjo rrit më tej zotërimin e nxënësit mbi procesin e nxënies.

Vlerësimi i shokut mund të shtojë edhe një dimension tjetër në zhvillimin e nxënësit nga pikëpamja e njohjes mbi veten. Nxënësit gjatë konsultimeve me shokët e tyre për marrjen dhe dhënien e sugjerimeve për përmirësim, marrin më shumë përgjegjësi për atë që bëjnë dhe mënyrën si e realizojnë. Në këtë mënyrë ata mendojnë në mënyrë analitike mbi natyrën e performancës së shokut të tyre. Projektet si detyra që përfshijnë një kombinim të aftësive të nxënies të tilla, si; kërkimi, planifikimi, projektimi dhe përfundimi, janë shembuj të mirë. Kjo gjithashtu praktikohet në ato situata ku nxitet një shkallë e lartë e ndërveprimit të nxënësit.

VI. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues, i lirë dhe sa më efektiv në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën Kurrikulare
- Kurrikulën bërthamë
- Programin mësimor

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i

përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

6.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën ose modulën përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndësore të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator- dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të lëndës.

6.2 Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator- dhjetor;
- periudha e dytë: janar - mars;
- periudha e tretë: prill- qershor.

Periudhat nuk janë semestra, por janë periudha reflektimi për mësuesit dhe nxënësit duke reflektuar mbi punën dhe rezultatet e tyre dhe si mund të përmirësohet në vazhdim.

Më poshtë jepet tabela e planifikimit të orëve mësimore në AMU (35 javë mësimore)

Gjuha e huaj e parë Klasa e VI, VII, VIII, IX (35x3=105)	Formimi kulturore	Formimi gjuhësor		Puna me portofolin (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		105 orë
	40%	30%	20%	10%	
	42 orë	32 orë	21 orë	10 orë	

Gjuha e huaj e dytë Klasa e VI, VII, VIII, IX (35x2=70)	Formimi kulturore	Formimi gjuhësor		Puna me portofolin (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		70 orë
	40%	30%	20%	10%	
	28 orë	21 orë	14 orë	7 orë	

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Tek orët e formimit kulturore përfshihen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj., duke ndihmuar në krijimin dhe forcimin e kompetencave kyçe. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përfortimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke pasur parasysh që përfaqja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënës, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore u referohen akteve të komunikimit që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e tjera.

Duke pasur parasysh se vlerësimi i nxënësit bëhet edhe përmes përdorimit prej tij të portofolit, mësuesit duhet të planifikojnë orë për realizimin e detyrave me Portofolin European të Gjuhëve. Mësuesi planifikon gjithashtu orë për projektin lëndor të cilat mund të merren nga orët e formimit kulturor ose gjuhësor.

Teste të detyruara gjatë një viti shkollor janë 3 të cilat kryen rreth përfundimit të çdo periudhe por jo detyrimisht orën e fundit.

Model planifikimi vjetor

Lënda: “Gjuhë e huaj” Anglisht

TOPICS	Subject content distribution		
	September -December (39 hours)	January – March (36 hours)	April - June (30 hours)
1 Welcome 9 hours	A- Back to School B- My World C- What’s New D- Self assessment (ELP- European Language Portfolio) E- Project F- Workbook exercises		
2 10 hours		
3 10 hours		
4 My health 12 hours		A- At the doctor`s B- Home Remedies C- Under the Weather D- Across Cultures E- Study Corner F- Project G- Workbook exercises	
5 12 hours		

6 12 hours		
7 Famous people 8 hours			A- My idol B- Classics C- The Long Goodbye D- Your Challenge E- Project F- Workbook exercises
8 10 hours		
9 12 hours		

6.3 Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planifikimin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyçe, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, te rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënësve, sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së ...”.

b. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i për zgjedh këto rezultate të nxëni nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës.

c. Numri rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

d. Kapitulli

Në këtë rubrikë shënohen kapitujt mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës.

e. Tema mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban:

Orë të detyruara për t'u planifikuar

- temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit. Mësuesi orientohet sipas tekstit mësimor;
- orët e projektit/ëve kurrikulare që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e gjuhës së huaj si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyç. Mësuesi në varësi të kushteve specifike mund të planifikojë në lëndën e gjuhës së huaj të paktën 5 – 9 orë projekte kurrikulare;
- orë ushtrimesh, përpunim njohurish, përsëritje për testin përmbledhës, etj., për të konsoliduar dhe zbatuar konceptet e fituara në lëndën e gjuhës së huaj;
- orët e testeve përmbledhëse për të matur njohuritë e fituara nga nxënësit në periudhën përkatëse. Mësuesi planifikon 3 teste përmbledhëse, nga një për çdo periudhë. Testet përmbledhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit e tij, d.m.th jo detyrismisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha.

f. Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g. Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh., harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, debat, dialog, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h. Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; portofol, prezantim me gojë ose punëme shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

i. Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënit si p.sh., teksti i nxënësit, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

Model planifikimi i orëve mësimore përnjë periudhe:

Në modelin e mëposhtëm paraqitet se si mund të planifikohet pjesa e fundit e një periudhe në gjuhën angleze:

SECOND PERIOD PLANNING

January-March

FIELD: Languages and Communication

Subject: English VII

Key Competences Learning Outcomes

The student:

- reads fluently with the proper intonation
- listens attentively to the teacher and friends
- uses his/her European Language Portfolio to document his/her work and plan his/her learning
- manages his/her emotions

Subject Competences Learning Outcomes

The student:

- uses basic sentence patterns and communicates with memorised phrases, groups of a few words about themselves and other friends, what they do, places, possessions
- uses the past tenses to talk about the past or describe photos
- has sufficient vocabulary to order food in a takeaway restaurant
-

No	Topics	Topics per hour	Learning situations	Methodologies and students activities	Assessment	Resources
1 12 hours
2 12 hours
3	Good friends 12 hours	1. In Touch- Reading and speaking 2. Grammar- Present Simple, WB exercises; 3. Friends- Listening and speaking- personality adjectives 4. ELP -Portfolio 5. Friday Afternoon- Reading & Listening 6. Speaking- Eating out and ordering food. WB exercises;	1. In Touch Teacher explains to students a situation where someone is at the airport and he/she wants to be in contact with his/her family. He/she does not have credits on his/her mobile. What should he/she do? Students brainstorm on the solutions. Then, students speak about ways they stay in touch with parents/ friends/ teachers etc. 2. Takeaway	<ul style="list-style-type: none"> • group work • pair work • brainstorming • questions and answers • gap filling • matching exercises • games • test 	<ul style="list-style-type: none"> • observati on • question and answers • assessing group work • home work • checklist • self-assessme nt 	<ul style="list-style-type: none"> • student book • workbook • picture dictionary • CD • Internet • Digital platform • Posters, photos • ELP

		7. Reinforcement-grammar& vocabulary	Students are set in a situation where they have invited friends over but they do not have food at home. So they decide to order takeaway food. They work in groups. (prepare the menu, plan what to order, why etc). Then students act out dialogues.			
		8. Test				
		9. Cross curricular topics (biology)- Reading and speaking				
		10. Writing- how green are you!				
		11. Project 12. ELP –Portfolio				

6.4 Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore duke pasur parasysh specifikat e çdo ore mësimore dhe klase.

Modele planifikimi ditor:

Shembull 1

Gjuhë Angleze (45+45 minuta)

Field: Language and communication	Subject: English	Stage: IV	Class: VIII	Date:
Topic: 1. Film Festivals		Learning Situation: Oscar winners		
Duration: 45`+45`				
Learning outcomes:		Key words:		
Student:		Director / main character / stunts / human emotions / actor / feature / plot / play / release / sound effects / cast / star		
<ul style="list-style-type: none"> • predicts the content of a text by using pictures • reads for specific information • listens for specific information • talks about films using newly learnt vocabulary 				
Resources:		Cross curricular link: Arts		
Student book , flash cards, projector, E-BEAM, smart board				
Methodology and activities				

First Class

Warm up (5 minutes)

- a. **Brainstorming:** students brainstorm on different kinds of films, vocabulary related to films etc. (mind maps)
- b. **Guessing:** students describe the pictures on the book and then guess the content of the reading passage using the pictures.

Reading (25 minutes)

- a. **Pre reading:** students listen to a recorded material and find out if their guessing was right.
- b. **While reading:** students read the text in silence and fill in the table on the book (ex 3)
- c. **After reading:** students discuss about the differences and similarities of the films described in the text.

Vocabulary quiz (15minutes)

- a. **The Bomb quiz:** Students divided into groups answer questions about the text to check comprehension and new vocabulary learnt.

5 min break

Second class

Group work: (10 minutes)

(Students are grouped in 6 groups by counting from 1 to 6; all the ones sit at one table, all the twos at another table and so on, the leader of the group chooses a flash card which contains three unfinished sentences about the information they already know about the films in the previous class). Each group finishes them and then groups exchange flash cards between each other and do peer editing. In the end each group presents the correct sentences.

Listening and speaking (10 minutes)

- a. **Pre listening/watching activity:** Ss answer the question “What is Oscar?”
- b. **While listening/watching activity:** Ss listen for specific information.
 - List the movie titles that are running for the trophy.
 - Name the main characters.
 - What was each movie about?
- c. **After listening/watching activity:** Students check their answers.

Speaking (15 minutes)

In groups students discuss and decide which of the three movies in ex.3 can be chosen as an Oscar winner and why. Each group gives three reasons and then the class votes for the winner.

Self assessment (10 minutes)

Students individually list what they can do after the 90 min class. (these can do statement can be used also when students will work with the European Language Portfolio)

<p>Now I can:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. 2. 3.
<p>Evaluation:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Exercises on speaking, reading and listening b. Rubrics will be used <p>Students will be assessed on their ability and performance to:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identify the information and new words while reading and listening (Level 2) • understand the main idea and demonstrating through simple examples (Level 3) • give arguments for his/her choice (Level 4)
<p>Home-work: Write an e-mail to your English friend telling him/her about the recent film you have seen.</p>

Shembull 2

Gjuhë frënge (45 +45 minuta)

Discipline:Langue et communication	Matière:Français	Niveau:3	Classe:6	Date:
<p>Thème 11-12 <i>Première séance:C'est mon ancêtre</i> <i>Deuxième séance:Les adjectifs possessifs</i></p>		<p>Situation d'apprentissage <i>L'arbre généalogique</i> <i>Photo de famille</i></p>		
<p>Résultats d'apprentissage selon les compétences au niveau domaine , matière <i>Première séance:</i> <i>Identifie un arbre généalogique</i> <i>Présente un arbre généalogique</i> <i>Deuxième séance:</i> <i>Exprime l'appartenance</i> <i>Présente sa famille à qqn</i></p>		<p>Mots clés <i>Famille:parents/mère /père /frère/soeur /grand-mère /grand-père les enfants</i> <i>Les adjectifs possessifs:mon/ ton /son ma/ ta /sa</i> <i>mes/ tes/ ses</i></p>		
<p>Matériels de ressource <i>Photo de famille,documents authentiques,cd,livre d'élève</i></p>		<p>Le lien éventuel avec d'autres domaines interdisciplinaires <i>Interculturel:quelques familles francais</i> <i>Convivialité: les relations parents/enfants</i></p>		
<p>Méthodologie et les activités des élèves</p>				

Méthode:question-réponse,recherche,interactive,lecture à haute voix.

Activités:activités de compréhension orale, activités de lexique ctd mots nouveaux du dialogue, activités de production orale à faire

en interaction, activités de préparation à l'écoute.

Première séance : 45 minutes

Phase 1 10 minutes

Faire observer la page aux élèves .Leur demander de réagir librement ,en langue maternelle,sur la photo qu'ils voient:

-Qu'est-ce qui est représenté sur la photo?

Attendre que les élèves aient donné la réponse en langue maternelle puis attirer leur attention sur le titre:"*Photo de famille.*"

Introduire les mots *la mère , le père , le frère, la soeur ,les enfants* pour préparer lesactivités.Ecrire les mots au tableau et leur demander de retrouver à qui ils peuvent correspondre sur la photo.

Inviter les élèves à faire le lien entre l'illustration du document 3 et 4 et de faire les suppositions sur ce personnage d'associer le personnage au domaine du cinéma.

Phase 2 20 minutes

Observer les documents et leur demander de déterminer ce que font les personnages.

-Ils regardent des photos. Leur demander d'observer le document 3 .

- Qu'est-ce que c'est?

Pour la réponse ,les élèves lisent les propositions de l'exercice1.

Écoute du dialogue et observation sur les illustrations pendant l'écoute.Leur faire lire les questions et ils doivent choisir la

la réponse correcte parmi les propositions et demander à un élève volontaire de lire à haute voix les affirmations proposées.

Fractionner l'écoute pour permettre aux élèves de se concentrer sur chaque information et leur laisser le temps d'inscrire V(vrai)ou F (faux) sur une feuille de brouillon.

Marquer une pause après :J'aime beaucoup le cinéma./Je n'ai pas de frère./Et ,voilà mes deux soeurs./c'est ton ancêtre?-Oui!

La mise en commun collective :Les élèves justifient les réponses fausses avec une phrase du texte.

Lecture à haute voix du dialogue par des élèves volontaires.

Phase 3 15 minutes

Présenter oralement sa famille en utilisant les mots du lexique dans les phrases simples.J'ai un/une ,frère/soeur

Il/Elle s'appelle.....

Les élèves doivent faire attention à la prononciation des mots.

Deuxième séance : 45 minutes

Phase 1 10 minutes

Les élèves découvrent et soulignent dans le dialogue les adjectifs possessifs: mon/ ton /son ma/ ta / sa mes/ tes/ ses devant les noms.

Trouver dans l'arbre généalogique la mère -mère, le père-mon père et transformer oralement les mots .

Phase 2 20 minutes

Leur demander d'observer les items de l'exercice 7 et le tableau et de réfléchir ,par groupe de deux ,à la personne à laquelle ils se rapportent.

-je-mon+nom masculin,ma+ nom féminin,mes+ nom pluriel.

-tu-ton+nom masculin, ta+ nom féminin,tes+ nom pluriel.

-il/elle-son+nom masculin, sa+ nom féminin, ses+nom pluriel.

Inviter les élèves à observer l'encadré N'oublie pas!

Phase 3 15 minutes

Présente la famille de Rémi. Les élèves observent l'arbre généalogique de la famille de Rémi, complètent le texte avec les mots importants des principaux membres de la famille et ensuite lisent le texte qu'ils complètent avec les mots proposés .

Évaluation

- Évaluer des réponses orales et écrites sur un arbre généalogique
- Évaluer le travail à deux et en groupe

Les apprenants vont être évalués sur ces compétences :

Identifier l'information et les mots nouveaux dans le dialogue à la compréhension écrite et à la compréhension orale (Niveau 2)

Décrire les photos en utilisant les mots et les expressions appris (Niveau 3)

Utiliser les mots et les adjectifs possessifs dans une production écrite (Niveau 4)

Réalisez l'arbre généalogique de votre famille

Shembull 3

Gjuhë italiane (45+45 minuta)

Campo: Lingua e comunicazione	Materia: Italiano	Grado: IV	Data:
			Classe: VIII-A
Temì di lezione : 1. <i>Bellissima questa piazza !</i> (prima ora) 2. <i>Citta` italiane .</i> (seconda ora)			
Risultati dell' apprendimento delle competenze del campo in base al tema di lezione :	Parole chiavi:	Metodologia, tecniche e	

<p>Ascolto: ascoltano con attenzione il dialogo</p> <p>Parlato: parlano sul tema e rispondono alle domande</p> <p>Scritto: riassumono per iscritto il dialogo ,completano gli esercizi di comparazione usando gli aggettivi tra le due città` come p.es: Firenze è meno moderna di Milano ecc.</p>	<p>-vivace</p> <p>-attraversare</p> <p>-comparazione</p> <p>-cospita!</p> <p>-caotica</p> <p>-accogliente</p> <p>-vivibile</p>	<p>attività degli alunni :</p> <p>-lettura e spiegazione</p> <p>-passo dopo passo</p> <p>-elenco griglia</p> <p>-pratica dettagliata</p> <p>-brainstorming</p> <p>-cluster</p>
<p>Collegamento con altri campi: Civiltà , lingua e comunicazione , geografia</p>	<p>Materiali:Libro, CD,registratore, informazioni sulle città , youtube video .</p>	

Situazione dell'apprendimento:

Usano gli aggettivi per comparare le qualità` delle due città`.

Esprimono le loro conoscenze sulla cultura italiana

Prima ora



Firenze



Milano

Organizzazione dell'ora di lezione

Primo passo: Lettura e spiegazione (Role play)

Spiego il brano in poche parole , mettiamo il CD per ascoltare il dialogo ,l'intonazione e le parole nuove.

Facciamo la lettura e spiegazione(10min). Gli alunni prendono i ruoli e interpretano in roleplay. (10min)

Secondo passo : Passo dopo passo

Rivolgo le domande della comprensione del dialogo (5 min). Spiego la funzione degli aggettivi e gli alunni elencano dal dialogo tutti gli aggettivi sottolineandoli (10min).

Traduco le espressioni in blu e le parole nuove e per compito di classe completano l'esercizio con gli espressioni equivalenti. Riassumono oralmente il dialogo con parole semplici (10min).

Seconda ora

Organizzazione dell'ora di lezione


Collegamento con l'altra ora di lezione

Primo passo: Brainstorming

Rivolgo domande di brainstorming tipo : quali sono le città principali d'Italia? Perché sono famose? Cosa ne sapete di loro? Vediamo insieme alcune video da youtube sulle città italiane (20min).

Secondo passo: Cluster

In forma di cluster completiamo l'Italia con le città principali Roma , Milano, Firenze, Venezia ecc. (10min).



Terzo passo :Pratica dettagliata

Compito di classe: per iscritto vedendo le due foto di Milano e di Firenze confrontano i vantaggi e gli svantaggi di una città antica con una città moderna usando gli aggettivi. Leggono le idee(15min). Do il compito di casa spiegando la richiesta in forma di esse devono descrivere "Le bellezze delle città italiane" usando gli aggettivi.

Valutazione:	L'uso corretto degli aggettivi comparativi usati. Le conoscenze, informazioni e la descrizione delle città italiane. Gli alunni saranno valutati nel loro abilità per: Identificare gli aggettivi comparativi usati (Livello 2) Usare degli aggettivi comparativi in dialoghi semplici (Livello 3) Paragonare le città italiane delle photo, usando gli aggettivi comparative (Livello 4)
--------------	--



Compiti di casa:

Per compito di casa in forma di esse devono descrivere "Le bellezze delle citta` italiane" usando gli aggettivi.

VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ

Vlerësimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënie - nxënies. Vlerësimi përdoret për:

- të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve;
- të matur arritjet e nxënësve;
- të gjykuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënie -nxënies;
- të raportuar arritjet;
- t'i dhënë sugjerime nxënësve për përparimin e tyre.

Vlerësimi në lëndën e gjuhës së huaj mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënimit të përshkruara në programin mësimor. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësit dhe mund të integrohet në të nxënimit normal të nxënësve.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënimit në lëndën e gjuhës së huaj nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënimit. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit mbledhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultateve të të nxënimit bazuar në nivelet e arritjes.

Vlerësimi i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- a. vlerësimit të vazhduar (vlerësimi për të nxënë-formative assessment-assessment for learning) (40%);
- b. vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (vlerësimi i të nxënimit -summative assessment-assessment of learning) (40%);
- c. vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit (20%).

a. Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë-for learning)

Vlerësimi i vazhduar është lloji më i fuqishëm i vlerësimit që ndihmon nxënësin në të kuptuarin e njohurive dhe performancën e tij. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep informacion mësuesit të planifikojë orë mësimi të cilat i përshtaten nevojave të nxënësit dhe duke u bazuar tek nivelet e

arritjeve për shkallën e caktuar. Mësuesi duhet t'i japë nxënësit koment të menjëhershëm në mënyrë që nxënësi të përmirësojë mangësitë që mund të ketë për koncepte të caktuara. Vlerësimi i vazhduar gjithashtu e ndihmon mësuesin të reflektojë mbi strategjitë dhe veprimtaritë e përdorura duke u bazuar tek niveli i të kuptuarit dhe performancës së nxënësve. Ky vlerësim bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi ***përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.***, përgjatë një periudhe.

Shembuj vlerësimi të vazhduar në gjuhën angleze: an interactive class discussion; a warm-up, closure, an on-the-spot performance; a quiz, etc

Vlerësimi i vazhduar synon të mbështesë nxënësin gjatë procesit të të nxënit, të masë përparimin e tij dhe t'i jepet ndihma e duhur në përmbushjen e rezultateve të të nxënit. Gjatë gjithë këtij procesi mësuesi duhet:

- Të planifikojë detyra për të vlerësuar që shkojnë përtej testimit të fjalorit dhe gramatikës.
- Të japë feedback të vazhdueshëm që shkon përtej identifikimit dhe korigjimit të gabimeve gramatikore.
- Të japë feedback konstruktiv për performancën dhe përparimin e nxënësit drejt përmbushjes së niveleve gjuhësore të arritjes.
- Të udhëzojë nxënësit për të zhvilluar aftësi efektive vetvlerësuese dhe vlerësimin e shokëve.

Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënit, mësuesi mban shënime në evidencë (fletore) për çdo nxënës. Shënimet në evidencë mund të mbahen kryesisht me simbole (por edhe me notë në raste specifike kur mësuesi është i bindur se nxënësi ka arritur nivelin që përshkruan nota e vendosur), të shoqëruara me komente të cilat i referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore dhe të aftësive në gjuhën e huaj.

Nxënësi ka 9 nota në regjistër deri në përfundim të vitit shkollor, të mjaftueshme për të nxjerrë notën përfundimtare.

Ndryshimi kryesor që ka ndodhur në vlerësimin e nxënësit gjatë zbatimit të kurrikulës së re është vlerësimi për të nxënë (vlerësimi i vazhduar). ***Fokusi kryesor i vlerësimit për të nxënë (vlerësimi të vazhduar) është që nxënësi të përmirësojë të nxënit e tij, si dhe të motivohet më shumë për të mësuar.*** Pra, vlerësimi për të nxënë nuk ka si qëllim kryesor vendosjen e një note, por të evidentojë te nxënësi pikat e forta dhe problematikat dhe ta ndihmojë që t'i

përmirësojë ato. Në këto kushte, mësuesi duhet të fokusohet te procesi i të nxënësit dhe jo te vendosja e notës.

Si dokumentohet vlerësimi i vazhduar (vlerësimi për të nxënë)?

- Fletorja personale dhe evidenca nënkuptojnë **të njëjtin dokument**. Pra, mësuesi ka vetëm një dokument për vlerësimin e vazhduar (vlerësimin për të nxënë).
- Mësuesi mban shënime në fletoren e tij personale (apo në evidencë) ecurinë e progresit të nxënësit lidhur me rezultatet e arritjes.
- Fletoren personale (evidencën) mësuesi **e formaton në mënyrën më të përshtatshme për të**, por duke ruajtur logjikën e vlerësimit për të nxënë. Me fletoren personale (evidencën) mësuesi është i lehtësuar nga ngarkesa ose nga presioni për të vënë nota në regjistër në mënyrë të vazhduar.
- Mësuesi është i lirë t'i mbajë shënimet në fletoren e tij personale (evidencë) duke vendosur **simbolet, që ai gjykon si të përshtatshme**, të shoqëruara me komente shumë sintetike, të cilat iu referohen niveleve të arritjes së kompetencave lëndore.
- Komenti përmban nivelin e arritjes duke e shënuar me simbolin përkatës (**p.sh., N₃ ose N₄**), si dhe **konceptin/konceptet përkatëse** për të cilin është vëzhguar nxënësi (p.sh., N3- Fjalitë kushtore ose N2- përdorimi i nyjes).
- Përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, punët individuale, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimi i nxënësit, vlerësimi i nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjet në aktivitete dhe diskutimet në klasë, detyrat e shtëpisë apo të klasës etj., **vlerësohen me simbole**. Vendosja e notës në mënyrë të vazhduar gjatë vlerësimit për të nxënë nuk ndihmon procesin e të nxënësit, motivimin e nxënësve për të nxënë dhe zhvillimin e kompetencave.
- Nota në fletoren personale (evidencë) mund të vendoset **vetëm** në raste specifike, siç janë testet e ndërmjetme apo punët me shkrim etj.
- Nota e vlerësimit të vazhduar që vendoset në regjistër në faqen “Vlerësimi periodik” duhet të jetë **rezultante progresive (ose regresive) e vlerësimeve që mësuesi ka mbajtur** në fletoren e tij personale.
- Fletorja personale (evidenca) **është objekt monitorimi, por nuk** duhet dorëzuar në përfundim të periudhës.
- Mësuesi **mban përgjegjësi për fletoren personale** dhe duhet të argumentojë notën e vlerësimit të vazhduar të vendosur në regjistër.

- Mësuesi duhet *të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor* fletoren personale (evidencën), teste/detyra të ndërmjetme, punët me shkrim, etj. Këto do t'i shërbejnë për të argumentuar notën e vlerësimit të vazhduar.
- Drejtuesit e shkollave nuk duhet të ngarkojnë mësuesit me detyrimin për të mbajtur dy dokumente për vlerësimin e vazhduar të nxënësve: evidencën e vlerësimit të vazhduar dhe fletoren personale të shënimeve, ato janë e njëjta gjë.
- Gjatë periudhës, mësuesi i lëndës ka përgjegjësi për të informuar nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e tij për progres.

<i>Nr.</i>	<i>Nxënësi / Data</i>	<i>27.09</i>	<i>....</i>	<i>.....</i>	<i>10.11</i>	<i>.....</i>	<i>Komentet (Nivelet e arritjes për njohurinë/konceptin përkatës)</i>
<i>1</i>	<i>Melina Shkurti</i>	<i>+</i>					<i>N3. Conditional 1</i>
			<i>++</i>				<i>N3. Asking and answering questions</i>
				<i>9</i>			<i>N4. Telling a story</i>
					<i>✓</i>		<i>N4. Using linking words</i>
						<i>++</i>	<i>Short quiz</i>

Legjendë(mësuesi mund të përdorë simbole të ndryshme): ++ (sh. mirë); + (mirë); - dobët; - - (sh. dobët) (pa detyra) ✓ (detyrat sh.mirë) etj. N1- Niveli 1; N2 – Niveli 2; N3 – Niveli 3; N4 – Niveli 4. ! Në përfundim të periudhës, vlerësimi i vazhduar mbyllet me një notë përmbljedhëse (NVv).

Nota e vlerësimit të vazhduar në këtë rast gjykohet në bazë të ecurisë (progresit ose regresit) të arritjeve të nxënësit përgjatë periudhës, pra **NVv është 10**. Në shembullin e mësipërm ecuria e nxënësit është progresive, por mund të jetë edhe regressive.

Evidenca (fletorja e shënimeve) menaxhohet nga vetë mësuesit. Mësuesi është i lirë të ndryshojë formatin e evidencës duke ruajtur llogjikën e vlerësimit për të nxënë dhe të përcaktojë vetë se si do të mbajë shënimet për ecurinë e nxënësit.

b. Vlerësimi me test/detyrë përmbljedhëse (summative assessment-assessment of learning)

Vlerësimi i të nxënit ndryshe quhet vlerësim përmbljedhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Ky është një vlerësim formal dhe kryhet edhe për efekt raportimi.

Si dhe kur realizohet testi/detyra përmbledhëse?

- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet ***vlerësimi me test ose me detyrëpërmbledhëse***, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Mësuesi ka lirinë të përcaktojë vetë nëse do të zhvillojë test apo detyrë përmbledhëse sipas specifikave të lëndës.
- Testi/detyra përmbledhëse planifikohet nga mësuesi. Kur përmyllet një grup rezultatesh të të nxënit dhe mësuesi është ***i lirë ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë atë***.
- Testi/detyra përmbledhëse është 45 minuta.
- Drejtoria e shkollës menaxhon organizimin e testeve ose detyrave përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës.
- Testi/detyra përmbledhëse ***jodomsdoshmërisht*** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton vetë kohën se kur do ta zhvillojë atë.
- Në momentin kur mësuesi ***vlerëson testet/detyrat përmbledhëse, i vendos*** notat në regjistër.
- Mësuesi duhet ***të ruajë deri në përfundim të vitit shkollor*** testet ose detyrat përmbledhëse.

c. Vlerësimi i portofolit lëndor të nxënësit (PEGJ)

Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve **krijuese dhe hulumtuese** të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohurive, shkathësive, qëndrimeve).

Për një periudhë, detyrat që vlerësohen në portofol janë:

- a. Projektin ose një fazë e tij, e cila është pjesë e detyruar e portofolit për çdo periudhë.
- b. 1 -2 detyra krijuese, zbatuese, hulumtuese etj.

(P.sh., në lëndët me 1-2 orënë javë portofoli mund të përmbajë një detyrë hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndorose gjithë projektin, ndërsa lëndët me më shumë se 2 orë, portofoli mund të përmbajë 2 detyra hulumtuese dhe një fazë të projektit lëndor ose gjithë projektin, nëse është projekt i vogël). Detyrat e portofolit duhet të jenë me të njëjtën temë për çdo nxënës. Detyrat e

portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si:

- punë praktike individuale,
- produkte të krijuara nga nxënësit,
- punime audio-vizuale,
- aktivitete në grup ose individuale;
- projekte individuale ose në grup;
- etj.

*Kujdes! Detyrat **NUK** duhet të jenë domosdoshmërisht të punuara me kompjuter.*

Si dokumentohet dhe vlerësohet portofoli?

- Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Mësuesi përcakton kriteret e vlerësimit të portofolit.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe iu prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e secilës detyrë të portofolit dhe kriteret e vlerësimit të tij.
- Vlerësimi i secilës detyrë të portofolit bëhet mbi bazë të kriterëve që mësuesi vendos, duke u bazuar në llojin e detyrës së dhënë.
- Mësuesi ka përgjegjësi për vlerësimin e portofolit bazuar në kritere vlerësimi duke argumentuar notën e tij.
- Instrumentet që mësuesi harton për kriteret e vlerësimit të portofolit ***nuk janë objekt monitorimi.***
- Detyrat e portofolit apo një fazë e projektit vlerësohen në momentin që ato dorëzohen ose prezantohen.
- Vlerësimi i portofolit mund ***të planifikohet si orë e veçantë*** në planifikimin e periudhave ose mund të realizohet përgjatë tri - katër orëve mësimore të periudhës.
- Mësuesi duhet të kujdeset që ***të mos mbingarkojë nxënësin me detyra*** në përfundim të periudhës. Ai, gjithashtu, mund të bashkërendojë punën me mësuesit e lëndëve të tjera për të shmangur ngarkesën e nxënësve.
- Vlerësimi i portofolit ***jo domosdoshmërisht*** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e gjykon vetë kohën se kur do të zhvillojë vlerësimin e portofolit.

- Në momentin që mësuesi ka përfunduar me *vlerësimin e detyrave të portofolit dhe të projektit ose të një faze të tij*, notat e portofolit i vendos në regjistër.
- Mësuesi duhet t'i udhëzojë nxënësit që t'i ruajnë detyrat e portofolit deri në përfundim të vitit shkollor ose t'i mbajë vetë këto detyra.

Nxënësit në lëndën e gjuhës së huaj përdorin Portofolin Europian të Gjuhëve (PEGJ), akredituar nga Këshilli i Evropës dhe është një dokument kurrikular i hartuar për tre qëllime kryesore:

- a. të mbështesë dhe të zhvillojë autonominë e nxënësit
- b. të forcojë ndërgjegjësimin ndërkulturor të nxënësit.
- c. të promovojë plurilingualizmin.

Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ) përbëhet nga tri pjesë:

- a. **Pasaporta Gjuhësore**- siguron një vështrim mbi zotërimin e gjuhëve të ndryshme që nxënësi di të cilat përcaktohen në bazë të aftësive dhe niveleve sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave. Aftësitë: TË KUPTUARIT (të lexuarit dhe të dëgjuarit); TË FOLURIT (ndërveprues dhe produkti i të folurit); dhe TË SHKRUARIT. Ndërsa nivelet janë: Niveli bazë (A1-zbulimi i gjuhës, A2-mbijetesa gjuhësore); Përdoruesi i pavarur (B1- Pragu i njohjes gjuhësore, B2- Zotërimi i gjuhës) dhe Zotëruesi i gjuhës (C1- Zotërimi shumë i mirë; C2- Zotërimi i plotë). Përfshirja e vetëvlerësimit në pasaportë thekson që PEGJ i përket nxënësit dhe jo institucionit.
- b. **Biografia gjuhësore**- ndihmon nxënësin të reflektojë mbi progresin e tij, të marrë pjesë në planifikim, e inkurajon të theksojë se çfarë mund të bëjë në secilën gjuhë që po mëson si edhe të informojë për përvojat gjuhësore të fituara gjatë dhe jashtë procesit të të nxënit. Nga pikpamja pedagogjike biografia gjuhësore luan një rol thelbësor duke përqëndruar vemendjen në procesin reflektiv që ndërmjetëson pasaportën gjuhësore me dosjen.
- c. **Dosja**- i ofron nxënësit mundësinë për të përzgjedhur materiale që dokumentojnë e ilustronë arritjet dhe përvojat e rregjistruara në Biografinë Gjuhësore ose në Pasaportë. Nxënësi mund ta plotësojë dosjen me rezultatet e punës së tij, të tregojë aftësitë në të shkruar e në të folur dhe mund ta realizojë edhe me anë të përfshirjes së CD në dosjen e tij.

Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit të cilat nxënësi i përzgjedh në Biografia Gjuhësore tek PEGJ

për një aftësi të caktuar (të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit) dhe nivelit përkatës (A1-A2):

Kujdes! Detyrat duhet të përfshijnë të gjitha aftësitë e gjuhës (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit).

PEGJ ka dy funksione:

- a. **Raportues**- tregon aftësitë e nxënësit në lidhje me gjuhët e huaja duke dhënë informacion rreth përvojave të tij dhe shembuj konkretë mbi arritjet e tij në gjuhë të huaj. Rëndësia e funksionit raportues të PEGJ-it ndryshon sipas moshës së nxënësit.
- b. **Pedagogjik**- PEGJ është hartuar me synimin e bërjes transparente të procesit të të nxënës të gjuhëve, duke ndihmuar nxënësin të zhvillojë kapacitetin për reflektim dhe vetvlerësim. Ky funksion përkon me synimet e Këshillit të Evropës për forcimin dhe zhvillimin e autonomisë të nxënësit.

Përdorimi i PEGJ në klasë:

Duke qënë një dokument kurrikular mësuesi duhet të planifikojë orë të veçanta dhe veprimtari të larmishme që nxënësi të punojë me këtë dokument si psh: punë në grup, punë në çift, projekte, ushtrime të krijuara nga nxënësit, diskutime etj.

- Në fillim të periudhës, mësuesi prezanton PEGJ dhe shpjegon nivelin gjuhësor që nxënësi duhet të arrijë në fund të vitit dhe në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat që mund të përfshijnë në dosje përgjatë periudhës. Nxënësit i jepet liri të zgjedhë detyrën e tij.
- Mësuesi në fillim të periudhës përcakton dhe u prezanton nxënësve peshat/pikët për vlerësimin e detyrave për të katër aftësitë gjuhësore.
- Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin dhe zhvillimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij.
- Mësuesi monitoron përgjatë gjithë periudhës zhvillimin e detyrave të portofolit.

Shembull 1

Mësuesi shpjegon funksionin raportues të PEGJ, thekson vlerën e shkallës së përbashkët Evropiane të zotërmit të gjuhës, inkurajon diskutim mes nxënësve rreth përvojave të mësimit të gjuhëve, tregon modelin e një portofoli të hartuar nga



nxënësit e viteve të mëparshme. Gjithashtu mësuesi nxjerr në pah idetë e nxënësve se si ta përdorim PEGJ në klasë.

Shembull 2

Nxënësit diskutojnë në grupe se çfarë ata mund të bëjnë në gjuhën e huaj që po mësojnë. Ata gjithashtu vendosin se çfarë ata duan të mësojnë gjatë vitit të ri shkollor. Kjo veprimtari mund të realizohet në fillim të vitit kur mësuesi prezanton PEGJ dhe përshkruarit për nivelin e caktuar. Nxënësit përgatisin postera duke u bazuar tek përshkruarit e aftësive gjuhësore të nivelit gjuhësor që ata janë dhe posterat vendosen në klasë për të shërbyer si pikë referuese në fund të çdo periudhe.

Shembull 3

Mësuesi nis një diskutim rreth shprehjes “Unë mund të bëj...” (në gjuhën që po mëson) (*theksoni të menduarin pozitiv, nxënësit përfytyrojnë se janë mes folësve të gjuhës etj*), vendos nxënësit në grupe dhe secili grup zgjedh një aftësi të caktuar (*të folur, të dëgjuar etj*) dhe shkruajnë sa më shumë fjali me “Unë mund” në nivelin gjuhësor për klasën përkatëse (psh A1- *unë mund të prezantohem; unë mund të kuptoj orientime të thjeshta; unë mund të kuptoj mesazhe të thjeshta në kartolina etj*)

Shembull 4

Mësuesi ndan klasën në çifte dhe secili nxënës praktikon një monolog të shkurtër duke zgjedhur një përshkruar (për shembull në nivelin A2 (klasa 6-7) – “Unë mund të përdor shprehje të thjeshta për të përshkruar njerëzit që njoh”). Mësuesi vendos një limit kohor për këtë veprimtari dhe u shpjegon nxënësve që njëri nga nxënësit do flasë dhe tjetri do të marrë rolin e mësuesit, duke kontrolluar kohën dhe duke dëgjuar me vëmendje për të dhënë feedback konstruktiv. Më pas nxënësit ndërrojnë rolet.

Shembull 5

Në fund të secilës periudhë mësuesi mund t’i angazhojë nxënësit të bëjnë vetvlerësimin e asaj që kanë mësuar dhe si e kanë mësuar. Mund të përdoret tabela e mëposhtme:

<i>Rreth të nxënësve</i>	<i>Rreth mësimeve</i>
<i>Unë kam mësuar</i>	<i>Më pëlqen më shumë</i>
<i>Unë mund</i>	<i>Gjëja më interesante është.....</i>
<i>Unë jam i mirë në</i>	

<i>Unë nuk kam arritur të</i>	<i>Mua nuk më pëlqen.....</i>
<i>Unë nuk kam kuptuar</i>	<i>Gjëja më e mërzitshme është</i>
<i>Unë kam vështirësi në</i>	

Nxënësit shënojnë rezultatet në një poster i cili mund të përdoret si pikë referimi për të planifikuar të nxënësit me të gjithë klasën për periudhën pasuese.

Për vlerësimin e portofolit mësuesi përcakton tabelën e pikëve për secilën detyrë.

Më poshtë është dhënë thjesht një shembull (periudha e dytë), i cili shërben për të ilustruar ndarjen e pikëve për secilën detyrë si edhe detyrën e periudhës për projektin, të cilat mësuesi ua komunikon nxënësve. Pikët mund të jenë të ndryshme për secilën periudhë në varësi të peshës që i jepet secilës detyrë.

Detyra e parë	Detyra e dytë	Projekti	Totali
20 pikë	20 pikë	10 pikë	50 pikë

Shënim: Për periudhat e tjera mësuesi cakton pikët për detyrat dhe projektin sipas rëndësisë dhe peshës së tyre. P.sh projekti në periudhën e tretë merr rëndësi më të madhe pasi nxënësit prezantojnë punën e tyre njëvjeçare, kështu vlerësohet me më shumë pikë.

Mësuesi gjithashtu përcakton tabelën e pikëve për notën (si në rastin e testeve).

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	< 12	13-19	20-25	26-32	33-38	39-45	46-50

Shembull

Për periudhën e dytë mësuesi në bashkëpunim me nxënësit ka përcaktuar të realizojë dy detyra të cilat përzgjidhen nga përshkruesit e PEGJ sipas nivelit gjuhësor.

Detyra e parë: (klasa 6- PEGJ – Niveli A2- të folurit)

Detyra e dytë:

“ Unë mund të prezantohem kush jam, ku banoj, çfarë shkolle frekuentoj dhe cilat janë dëshirat e mia.” (I can say who I am, where I live, which school I go to and what I like.) Nxënësi përgatitet për detyrën dhe e prezanton në klasë, pasi mësuesi i ka bërë të ditur kriteret dhe pikët e vlerësimit.

Për vlerësimin e kësaj detyre mësuesi mund të përdorë tabelën e mëposhtme:

	Fluency	Pronunciation and accent	Vocabulary	Grammar	Details
4	Smooth and fluid speech; few hesitations;	Pronunciation is good; good effort at accent	Good language control, a wide range of well-chosen vocabulary	Accuracy & variety of grammatical structures	Additional details beyond the required
3	Speech is relatively smooth; some hesitation	Pronunciation is good; Some effort at accent	Adequate language control; vocabulary range is lacking	Some errors in grammatical structures possibly caused by attempt to include a variety.	Good level of description; all required information included
2	Speech is frequently hesitant with some sentences left uncompleted;	Pronunciation is okay; No effort towards a native accent	Weak language control; basic vocabulary choice with some words clearly lacking	Frequent grammatical errors even in simple structures that at times obscure meaning.	Description lacks some critical details that make it difficult for the listener to understand
1	Speech is slow and hesitant	Pronunciation is lacking and hard to understand	Weak language control; vocabulary that is used does not match the task	Frequent grammatical errors even in simple structures; meaning is obscured	Description is so lacking that the listener cannot understand
Total _____ / 20					

VIII. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRAT E NDRYSHME NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ

8.1 Kriteret për kryerjen e detyrave

Mësuesi duhet të përcaktojë kritere vlerësimi për çdo detyrë dhe të sigurojë udhëzime të qarta për nxënësit se si do të jetë detyra e përfunduar dhe si do të zbatohen kriteret. Kur vendosni një detyrë sigurohuni që:

- kërkesat e detyrës janë bërë sa më qartë të jetë e mundur për nxënësin;
- kriteret e vlerësimit dhe nivelet e arritjes t’i ofrohen çdo nxënësi në mënyrë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë;
- çdo burim ose material i përdorur të jetë i qartë dhe i përshtatshëm për detyrën;
- arritjet e nxënësit maten për më shumë se një rezultat të nxëni;
- udhëzimet të jenë të qarta dhe koncize;
- niveli i gjuhës të jetë i përshtatshëm për vlerësimin;
- detyra nuk përmban gjini, kulturë ose ndonjë paragjykim tjetër;
- koha e lejuar është e mjaftueshme për kryerjen e detyrës.

8.2 Reflektimi ose komentit i mësuesit (Giving feedback)

Kur vlerësoni detyrën, mos harroni se reflektimet/komentet tuaja do të ndihmojnë nxënësin të kuptojë pse ai / ajo mori atë rezultat dhe si mund të bëhet më mirë herën tjetër.

Komenti duhet të jetë:

- konstruktiv në mënyrë që nxënësi të ndihet i inkurajuar dhe i motivuar për t’u përmirësuar;
- në kohë, në mënyrë që nxënësi ta përdorë atë për të mësuar në vazhdim;
- i menjëhershëm në mënyrë që nxënësi të mund të mbajë mend atë qëbëri dhe të reflektojë në kohë;
- i fokusuar në arritje dhe përpjekje, jo te personi - puna duhet të vlerësohet, jo nxënësi;
- specifik për rezultatet e të nxënit në mënyrë që vlerësimi të jetë i qartë lidhur me të mësuarin.

Përgjigjet (komentet) e mësuesit mund të jenë:

- informale ose indirekte - të tilla si reagimet verbale në klasë (me tërë klasën), ose në mënyrë individuale me vetë nxënësin.
- formale ose të drejtpërdrejta - të tilla si listat e kontrollit ose komentet për nxënësin në mënyrëindividuale, në formë të shkruar ose verbale;
- formative—të dhëna gjatë mësimit me qëllim ndihmës për nxënësin që të dijë se si të përmirësohet;
- përmbledhëse – të dhëna në fund të periudhës (ose të kapitullit) me qëllim informimin e nxënësve për çfarë kanë arritur.

IX. TESTET E ARRITJEVE

Një test është një vlerësim formal, përmbledhës, i strukturuar i arritjeve të nxënësve dhe i progresit të nxënësit. Testet janë një aspekt i rëndësishëm i procesit të mësimdhënies - nxënies nëse ata janë të integruar në “rutinën” e klasës dhe nuk trajtohen thjesht si një strategji “përmbledhëse”. Ata i lejojnë nxënësve të monitorojnë progresin e tyre dhe ofron informacion të vlefshëm për mësuesin në planifikimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies - nxënies. Testet ndihmojnë në prparimin e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me mësimin dhe rezultatet e të nxënësit. Dëshmitë tregojnë se teste të shkurtra janë më efektive për progresin e nxënësit se sa një test i gjatë. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që testet të korrigjohen dhe nxënësve t’u jepet përshtypja për performancën e tyre. Testet e hartuara në klasë zbulojnë rreth njohurive të nxënësve për përmbajtjen dhe për zhvillimin e të menduarit. Përgjithësisht pyetjet e hapura japin informacion më të detajuar në lidhje me aftësitë e nxënësve sesa një pyetje në të cilën ka vetëm një përgjigje.

9.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve. Prandaj:

- nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënësit për një kapitull ose periudhë të caktuar;
- duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- pyetjet duhet të ndryshojnë nga më e thjeshta te ajo më komplekse;
- pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;
- pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme (po/jo, e saktë/e gabuar, me zgjedhje të shumëfishtë, çiftim i elementeve, plotësim i vendeve bosh, zëvendësim i elementeve; përgjigje e zgjeruar, përgjigje e shkurtër etj.)

Testet duhet:

- të jenë të lehtë për t’u lexuar dhe të ketë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxënësit;
- të mund të kryhen nga nxënësit me nevoja të veçanta;
- t’ju krijojnë mundësi nxënësve të zgjidhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra;

- të kenë nivele të ndryshme të pyetjeve;
- të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;
- të mos ngatërrohen me minitestet të cilat masin rendimentin e orës së mësimit dhe kanë vetëm një kërkesë.

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish të lëndës së gjuhës së huaj mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- Numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. Ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës së një periudhe, i përvetësimit vjetor të lëndës etj.
- Është mirë që testet të hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme;
- Pyetjet në test është mirë të radhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre.
- Numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta.
- Gjatë hartimit të një testi është shumë e rëndësishme vlefshmëria e pyetjeve të tij(d.m. th. garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehi që ne i kemi vënë vetes si qëllim të kontrollojmë).

9.2 Hartimi i testit

Hartimi i testit të gjuhës së huaj bazohet te bazat metodologjike të hartimit të testeve.

Pjesa më e rëndësishme e fazave/hapave, nëpër të cilat kalon hartimi i testit të vlerësimit lidhet me strukturën e tij, e cila ndërtohet duke u bazuar në këto faza:

- Përcaktimi i aftësive dhe koncepteve që do të testohen me peshën përkatëse (% e pikëve që do të zënë secila aftësi);
- përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test (Niveli i dytë i arritjes së kompetencave(rekomandohet 40%) përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave (rekomandohet 40%), përfshin pyetjeku nxënësit nuk i mjafton të kujtojë procedura rutinë, ose të imitojë zgjidhje standarde. Ai duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën, sidoqoftë mund ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon.Niveli i katërt i arritjes së kompetencave (rekomandohet 20%) përfshin pyetje ku nxënësi gjykon,zgjidh, jep mendim, vlerëson, harton duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.)

- Ndërtimi i tabelës së specifikimit (Tabela e Blue –Printit);

Konceptet/ aftësitë	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënit	Niveli II i arritjes së kompetencave	Niveli III i arritjes së kompetencave	Niveli IV i arritjes së kompetencave
.....
Pikët totale të testit	100% = ... pikë		40%= ... pikë Ose 35%	40% = ... pikë Ose 40%	20%= ... pikë Ose 25%

- hartimi i pyetjeve të testit.
- përcaktimi i skemës së vlerësimit (bazuar në shpërndarjen normale). Sistemi i pikëzimit që përdoret më shumë është ai që quhet analitik. Dy nga elementet bazë të këtij sistemi janë:
 - a. caktimi i pikëve për konceptet që testohet;
 - b. skema e pikëzimit (ku jepen kriteret e shpërndarjes së pikëve që janë akorduar për konceptet që do të testohen, duke pasur parasysh për bazë përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje).

Në konvertimin e pikëve me nota, kufiri i poshtëm rekomandohet 25% e totalit të pikëve. Më pas caktohet intervalet e pikëve nga nota 4 – 10.

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja e pikëve	<25%	25-38%	39-51%	52-64%	65-77%	78-90%	91-100%

9.3 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste

Pyetjet mund të jenë:

a. Objektive :

Këto pyetje quhen objektive pasi vlerësues të ndryshëm, që vlerësojnë në mënyrë të pavarur arrijnë në të njëjtin vlerësim, duke u bazuar në një çelës përgjigjesh të sakta.

b. Subjektive :

Këto pyetje quhen subjektive pasi nxënësi do të shprehë thjeshtë mendimin e tij, ndjenjat, vlerësimin pozitiv ose negativ rreth një çështjeje të caktuar.

Disa nga llojet e pyetjeve që mund të përdoren në teste paraqiten si më poshtë:

1. Pyetje të hapura (open-ended questions)

Në bazë të gjatësisë së përgjigjeve që kërkojnë këto pyetje ndahen në katër lloje.

- Plotësime fjalish (Cloze or completion questions)
Nxënësit i kërkohet të përfundojë një fjali të papërfunduar.)

Shembull: The highest mountain in Europe is _____.

- Pyetje me përgjigje të shkurtra (Short-answer questions)
Nxënësit i kërkohet të përgjigjet shkurt, me një shprehje, me një fjali të thjeshtë, qoftë edhe me një fjalë.)
- Pyetje me përgjigje të zgjeruar (Extended-answer questions)
Nxënësit i kërkohet të përgjigjet me fjali të përbëra ose komplekse, duke dhënë shpjegimet e duhura)
- Pyetjet e tipit ese (Essay-type questions)
Nxënësit i kërkohet të prodhojë një pjesë të përmbledhur në një numër të caktuar fjalësh, me tekst të strukturuar ku të paraqitet qartë hyrja, seksioni qendror dhe mbyllja.)

2. Pyetje me alternativa (multiple choice).

Një pyetje me zgjedhje të shumëfishtë përbëhet nga dy pjesë: nga trunghi dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë.

- Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik.
- Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra - tjetrën.
- Pyetjet ndërtohen në përgjithësi me 4 alternativa.
- Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë.
- Alternativat duhet të jenë homogjene dhe t'i referohen të njëjtës kategori.
- Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalesh kohore.
- Vetëm një alternative është e saktë. Nëse mund të jenë dy alternative mësuesi specifikon "Zgjidh dy alternative" dhe në këtë rast kjo pyetje ka 2 pikë.
- Pyetja me alternativë vlerësohet me një pikë.

- Në përgjithësi rekomandohet të mos përdoren si alternative shprehjet “asnjë nga të mësipërmet”, ose “të gjitha të mësipërmet”.
- Pyetjet me alternativa shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.

Shembull

1. Would you like some more dessert?

- Enjoy your meal!
- No thanks, I'm full.
- It's delicious.
- Help yourself, please.

3. Pyetjet “Po/Jo” ose “e vërtetë/ e gabuar”

Përgjigja e saktë për këto lloj pyetjesh vlerësohet me një pikë.

Shembull

Sophie`s – Café & Bar
Traditional British cooking. Daily vegetarian specials. Fashionable décor that fits the cuisine. Smoking on the terrace only.
All major credit cards accepted. Reservations accepted for large groups only.
Lunch served: 12.30-2.30pm
Dinner served: 6.00-9.00 pm

No	Sentence	True	False
1	Lunch is served for two hours only.		
2	People can not pay by credit card.		
		





4. Pyetjet me çiftim (matching)

Këto lloj pyetjesh janë efikase për të testuar nëse nxënësi ka kuptuar informacionin e dhënë për të lexuar, mund të ristrukturojë informacione komplekse, ose të bëjë kombinimin e duhur të fjalive të përbëra ose komplekse.

Për çdo çiftim të saktë jepet një pikë, pra nëse ushtrimi ka 4 kombinime nga të dy kolonat, ai do të marrë 4 pikë, nga 1 për çdo kombinim të saktë.

Shembull 1

Match the sentences from 1 to 4 with the Notices from A to D.

1	You cannot let your dog run free here.	A	
2	Busses will not wait here.	B	
3	Check you have all your bags before you go.	C	
4	There are changes at the beginning of autumn	D	

Shembull 2

Match the two columns to have a meaningful sentence.

1	The rain started	a	when he was young.
2	He was a famous hockey player	b	before I was awarded the literature prize.
3	I wrote many books	c	while I was driving home.
4		

5. Pyetjet me plotësim (Gap filling)

Për çdo plotësim të saktë jepet një pikë.

Shembull 1

Complete this letter. Write one word for each space.

Dear Sir / Madam,

I stayed(a) _____ the Grand Hotel last week (b) _____ Tuesday to Thursday. I think I left a gold ring (c) _____ my hotel room. I (d) _____ in room 309. It (e) _____ be in the cupboard next (f) _____ the bed. Please (g) _____ you look for it? (h) _____ you find it, can you send it to me?

Thank you very much,

Celia Hicks.

Shembull 2

Read the article about a student. Fill in the gaps with the correct word.

My name's Hannah and I'm twenty years old. I've got a daughter (a) _____
(calls/called/names) Nicole. She's (b) _____ (nearly/quite/yet) three now. I live in a small
flat (c) _____ (in/on/at) the city centre. It isn't a nice place to live. It's very noisy and dirty and
there is (d) _____ (somewhere/anywhere/nowhere) for Nicole to play.

6. Renditja sipas radhës së duhur (Ordering)

Ky tip ushtrimi konsiston në renditjen e disa elementeve sipas radhës së duhur duke formuar një
fjali, pohim të plotë ose edhe një tregim të shkurtër.

Shembull 1

What's the correct order to make a correct sentence?

a / decided/ go/ on/ picnic/ to/ we

Shembull 2

Put the sentences in the correct order so as make a story:

- After washing her face she
- She left home at
- Mira woke up at seven o'clock.
-

7. Gjetja e fjalës (word completion)

Shembull: People wait for the train here. P _ _ _ _ _ .

9.4 Modele testesh

Shembull 1

Test 50 minuta Klasa VIII (Gjuhë Angleze)

Plotësimi i tabelës së specifikimeve (Blueprint)

Afësitë	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënësve Nxënësi:	Niveli II i arritjes	Niveli III i arritjes	Niveli IV i arritjes
Të lexuarit (reading comprehension)	21 points 46%	<i>finds the main idea in a text</i>		Ex.1	
		<i>finds specific info and details</i>		Ex.1	

		<i>guesses the meaning of a phrase or a word</i>			Ex.1
		<i>comprehends a short text</i>	Ex.2	Ex.2/3	Ex.2/3
Përdorimi i gjuhës (Use of language)	14 points 32%	<i>uses correctly question words and sentence structure.</i>	Ex.4	Ex.4	
		<i>uses conditional 1 sentences and simple past tense</i>	Ex.5	Ex.5	
		<i>uses correctly the conversational language</i>		Ex. 6	Ex.6
Të shkruarit (writing)	10 points 22%	<i>writes a short letter in informal way</i>	Ex.7	Ex.7	Ex.7
	100% 45 pikë		40% 18 pikë	40% 18 pikë	20% 9 points

Shënim: Mësuesi sipas mundësive dhe nivelit të klasës udhëzohet që të përfshijë edhe aftësinë e të dëgjuarit dhe të folurit në test.

Tabela e pikëve

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	<11	11-17	18-23	24-29	30-34	35-40	41-45

Reading Comprehension

- I.** You will read an article about the German Language Olympics. For the next 5 questions, answer A, B, C or D **6 points**

Eighteen-year-old Ai Nakishima studies at Kyoto University. She has learnt German for four years and has come to the Language Olympics together with two other students from Japan. 'There are 132 young people here,' she says. 'We're sleeping at a school in a village not far from Dresden.

Every morning we take the bus to the language school near the city centre. Before lunch we work together on projects for the competition. There are five of us in my **team**, all from different countries. We're writing a play and we'll perform it in front of an audience of German

teachers. I'd love to win the first prize. It's a two-week holiday in Berlin next year.

'In the afternoons we go on trips or visit the old town. So far we've been to the opera and three museums. I liked the boat trip on the River Elbe best. We went as far as the mountains. It was really great!'

1. What is Ai doing in Dresden?
 - A. studying German at university
 - B. visiting some Japanese friends
 - C. taking part in a competition
 - D. climbing mountains
2. Where are Ai and the other young people staying?
 - A. in a school in the country
 - B. at a language school in the city
 - C. in a hotel outside the city
 - D. with a family
3. During the morning Ai
 - A. acts in plays
 - B. learns different languages.
 - C. works with her group.
 - D. goes to the opera
4. What does Ai hope to win?
 - A. a theatre course
 - B. trip to Berlin
 - C. language lessons
 - D. climbing race
5. Which afternoon activity did Ai enjoy most?
 - A. climbing a mountain
 - B. going along the river
 - C. visiting a museum
 - D. walking around the old town
6. What does the word team in Prg.2 mean?
 - A. a group of German teachers
 - B. a group of German students
 - C. a group of Japanese students
 - D. a group of international students

II. Complete the gaps in the text below with an appropriate word chosen from the list below.

7 points

Don Quixote by Miguel de Cervantes

Don Quixote, a retired country (a) _____ in his fifties, lives in an unknown (b) _____ of La Mancha with his niece and a housekeeper. He has become (c) _____ with books of noble knights, and believes their every word to be (d) _____, despite the fact that many of the events in them are clearly (e) _____. Don Quixote eventually appears to other (f) _____ to have lost his mind from little sleep and food and (g) _____ so much reading.

obsessed / gentleman / impossible / because of / place / true / people

III. You are going to read a friend letter. 8 sentences or word groups have been removed from it. Choose from the sentences or phrases (1–8) the one which fits each gap (A-H).

8 points

My dear Viktor,

(a) _____ you asked me to describe one of our festivals. Dear friend, Diwali is our most amazing (b) _____. It is a festival of lights. It is celebrated (c) _____ and the beginning of the winter season. It is celebrated all over India in honour of Lord Rama's return to Ayodhya after a long exile in the forest.

(d) _____ many days before the festival. The houses and shops are painted, well cleaned and gaily decorated. In every house sweets are prepared or purchased from the market.

Sweets are exchanged (e) _____.

The day itself is marked with great joy and merry making. Some people illuminate their houses

(f) _____. The children specially enjoy this festival. They get toys, sweets and (g) _____. They explode crackers and have fun like crazy. (h) _____ to compare it in any religion or country.

Yours Sincerely,

.....

1. Great preparations are made
2. and colourful festival
3. In your previous letter
4. at the end of the rainy season
5. There is nothing
6. among friends and relatives
7. with multicoloured electric lamps
8. delicious dishes to eat

A ____; B ____; C ____; D ____; E ____; F ____; G ____; H ____.

Language use

IV. Match the one part of the sentence on the right with the other part of the sentence on the left to make a complete sentence.

5 points

1	How far	a	did you find the new film?
---	---------	---	----------------------------

2	What kind	b	is it to the nearest drugstore?
3	Where	c	did you go to the drugstore?
4	When	d	of book do you want?
5	How		is the nearest drugstore?

V. Choose the answer which best completes each sentence. You should choose from A, B, C or D. There is *ONLY ONE* correct answer for each question. **4 point**

1. If it snows, we _____ the school trip tomorrow.
 - A. don't have
 - B. won't have
 - C. aren't having
 - D. aren't going to have
2. If she _____ at seven o'clock, she will catch the bus.
 - A. will get up
 - B. gets up
 - C. is getting up
 - D. got up
3. My mum was cooking dinner when the telephone _____.
 - A. was ringing
 - B. rang
 - C. ringed
 - D. rung
4. My brother _____ football every Friday.
 - A. plays
 - B. is playing
 - C. will play
 - D. played

VI. Choose the word or phrase from the list given which best completes the following conversation. **5 points**

<i>Thank / sorry / there is / another / help</i>
--

In a Restaurant:

Waiter: Yes sir, how can I (a) _____ you?

Customer: I don't want to bother you but (b) _____ a fly in my soup.

Waiter: I am terribly (c) _____! I will take the soup back to the kitchen and get you (d) _____ one.

Customer: (e) _____ you very much.

Writing

VII. Write a message of up to 70 words.

10 points

Your friend Ben from London sent you a link to his travel blog and asks you to give your opinion on the following:

- Do you like travel blogs?
- What pictures should be posted on a travel blog?
- What topics should be discussed (travelling with friends, family etc.)?
- Do your friends like reading travel blogs?

	Content	Organization	grammar	vocabulary	mechanics
points	2	2	2	2	2

Shembull 2

Klasa IX- 50 minuta (GjuhëFrënge)

Plotësimi i tabelës së specifikimeve (Blueprint)

Afësitë	Përqindja = Pikët	Rezultatet e të nxënët Nxënësi:	Niveli II i arritjes	Niveli III i arritjes	Niveli IV i arritjes
Të lexuarit (compréhension écrite)	21 points 46%	<i>Trouve l'idée principale d'un texte</i>		Ex.1	
		<i>Trouve des informations spécifiques</i>		Ex.1	
		<i>Trouve le sens détaillé des mots et expressions</i>			Ex.1
		<i>Comprend un petit texte</i>	Ex.2	Ex.2/3	Ex.2/ 3

Përdorimi i gjuhës Utilisation de la langue	14 points 32%	<i>Utilise d'une manière correcte la phrase interrogative et les réponses.</i>	Ex.4	Ex.4	
		<i>Utilise correctement les différentes structures de la grammaire (conditionnel, subjonctif etc</i>	Ex.5	Ex.5	
		<i>Utilise correctement les structures d'une conversation de la vie quotidienne</i>		Ex. 6	Ex.6
Të shkruarit Production écrite	10 points 22%	<i>Ecris une letter informelle</i>	Ex.7	Ex.7	Ex.7
	100% 45 pikë		40% 18 pikë	40% 18 pikë	20% 9 points

Shënim: Mësuesisipasmundësivedhenivelit të klasësudhëzohetqëtëpërfshijëedheaftësinë e tëdëgjuaritdhetëfoluritnë test.

Tabela e pikëve

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	<11	11-17	18-23	24-29	30-34	35-40	41-45

I. Compréhensionécrite

6 points

Des milliers ‘dineurs en blanc’ au pied de l’Arc de Triomphe.

Un ‘repas en blanc’ a réuni jeudi soir des milliers de gens à Paris dans un endroit tenu secret jusqu’à la dernière minute selon la règle du jeu, cette année au pied de l’Arc de Triomphe. En moins d’un quart d’heure, les participants, tout blanc vêtus, ont installé chaises, et vaisselles sur de petites tables pliantes pour déguster un repas arrosé de vin ou de champagne sur les terre-pleins séparant les avenues qui partent de la place de l’Etoile.

Ils étaient 7500 selon les organisateurs, 2000 selon la police. La moitié est arrivée par cars de la région parisienne, l’autre, des jeunes pour la plupart, en métro, mais tous avec le même objectif: être à table à 21h40. De tous âges, ils portaient des tenues blanches,

La police est arrivée 10 minutes plus tard mais s'est contentée d'observer la foule attablée qui sirotait du vin dans l'un des endroits les plus fréquentés du capital, par les touristes, comme par les voitures.

Paris, AFP, 18/06/2007

Lisez le texte et cochez la bonne réponse

1. Cet événement est

- A) un diner
- B) un pique-nique
- C) une réunion folklorique traditionnelle
- D) un jeu

2. Cet événement est

- A) interdit
- B) autorisé
- C) toléré
- D) obligatoire

3 Les participants portent

- A) tous les mêmes vêtements
- B) toutes les sortes de vêtements
- C) aucun vêtement de couleur
- D) des costumes de fête

4. Les participants viennent

- A) de toute la France
- B) de Paris et de ses environs
- C) de l'étranger
- D) seulement de Paris

5. Les participants sont

- A) seulement de jeunes
- B) des jeunes et des moins jeunes
- C) des personnes âgés
- D) de différents âges

6 La police est arrivée

- A) en avance
- B) à l'heure
- C) en retard
- D) trop tard

II. Complétez la lettre suivante à l'aide des mots ci-dessous (7 points)

Salut Linda

Il y a trois semaines que je n'ai pas eu de tes _____ . Mes vacances se passent bien. Mes deux _____ de Lyon sont arrivés hier . Ils sont très _____ comme moi . et nous faisons de belles promenades

Nous allons chaque matin _____ Nous jouons aux balles et nous nous baignons même si l'eau du lac est un peu _____ .

Raconte -moi ce que _____ et envoie moi _____

Je t'embrasse

Caroline

Cousins /à la plage / nouvelles/froide /une carte postale / tu fais
--

III. Vous devez écrire une lettre à un ami. 8 mots ou groupes de mots sont enlevés de la lettre. Choisissez le mot ou groupe de mots de la liste ci -dessous pour remplir le texte (8 points)

Salut Paul,

J'espère que tu vas bien et que tes vacances(a)_____. Je suis rentre de la Grèce, hier. J'ai passé un séjour(b)_____ avec ma famille. Pendant notre séjour j'ai visité des musées, j'ai goûté des plats (c)_____, j'ai visité des villages typiques et des marchés où ma mère a fait (d)_____. Je suis aussi allé à la mer et j'ai fait un voyage (e)_____ Super ! J'ai fait aussi(e)_____. Mes parents aussi ont aimé (f) _____ et je pense qu'on(h)_____ l'été prochain.

Amicalement

Ian

1. *ce séjour*

2. *de la voile*

3. *beaucoup d'achats*

4. *se sont bien passées*

5. *va y retourner*

6. *formidable*

7. *délicieux*

8. *en bateau*

A _____ B _____ C _____ D _____ E _____ F _____ H _____

UTILISATION DE LANGUE

IV. Reliez les questions et les réponses à l'aide des flèches (5 points)

1. Pouvez –vous me dire à quelle heure a eu lieu l'éclipse ?	A. Nous irons certainement faire du ski
2. Où passeras –tu les vacances d'hiver avec ta famille	B. Il est en cuir rouge avec de nombreuses poches
3. Peux –tu me décrire le sac que tu as acheté	C. Je vais très souvent au cinéma
4. De quel écrivain aviateur parle –t –on	D. Je ne suis pas sûr peut être vers 15 heures
5. Quelle est votre activité préférée?	Il s'agit de Saint –Exupéry, l'auteur du Petit prince

V. Cochez la bonne réponse afin de construire des phrases correctes 4 points

1. Si tu avais du temps _____ tous ces livres
 - A) tu liras
 - B) tu aurais lu
 - C) tu lirais
 - D) tu as lu
2. Hier ma cousine _____ de l'école à 13 heures
 - A) a sorti
 - B) est sorti
 - C) sort
 - D) est sortie
3. Je voudrais que les mes résultats cette année _____ meilleurs
 - A) seront
 - B) sont
 - C) étaient
 - D) soient
4. Le livre _____ tu nous a parlé est très intéressant
 - A) que
 - B) qui
 - C) dont
 - D) lequel

VI. Choisissez le mot ou l'expression de la liste ci-dessous et complétez le dialogue. 5 points

en retard /ne quittez pas /salut/demain / un ami

Au téléphone

Colette: Oui allo?

Felix « : Bonjour, madame, je suis Felix , _____ d'Anatole .Il est là, s'il vous plait?

Colette: Oui il est là , _____ Anatole , c'est pour toi

Anatole: Allo?

Felix: _____, Anatole, c'est Félix Ca va

Excuse – moi je suis _____

Anatole; Ce n'est pas grave

Felix: Tu viendras _____ au bureau. Nous avons une réunion importante

Anatole; Désolé je ne peux pas j'ai un rendez –vous

ÉCRITE

VII. Vous écrivez un courriel à un(e) ami (e) français(e). Vous l'invitez à passer des vacances dans votre pays. Vous lui proposez une date et vous parlez des activités que vous allez pouvoir faire ensemble.

(70 mots)

10 points

Objet: Invitation

	Réalisation de la tache	organisation	Grammaire	Lexique	Orthographe
points	2	2	2	2	2